

RAPORTI VJETOR I VEPRIMTARISË SË AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË PËR VITIN 2009

HYRJE

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, e themeluar më 1972, është institucioni më i rëndësishëm shkencor në Republikën e Shqipërisë. Ajo përfshin shkencëtarë nga më të shquarit, akademikë, akademikë të asociuar dhe akademikë nderi, të cilët zhvillojnë veprimtari kërkimore-shkencore në institute e qendra studimore - kërkimore dhe organizma të tjerë shkencorë si brenda dhe jashtë vendit.

* * *

Akademia e Shkencave e Shqipërisë i ka zanafillat e saj në vitin 1750, kur, në Voskopojë u krijua e ashtuquajtura "Akademia e Re". Në atë kohë, ajo ishte njëherazi shkollë e mesme dhe qendër kulturore e mirënjohur jo vetëm në Shqipëri. Ndonëse "Akademia e Re" nuk kishte as strukturën, as detyrat e Akademive të vendeve të tjera të Europës, ajo ishte e lidhur me trashëgiminë dhe zhvillimet kulturore të popullit shqiptar. Shqiptarët kanë qenë për shekuj me radhë nën sundime të qeverisjeve të huaja, por ata mundën të mbijetonin duke ruajtur e zhvilluar gjuhën dhe kulturën e vet të origjinës. Përpjekjet e shqiptarëve për të lëvruar dijet e tyre nuk kanë munguar ndër shekuj. Kontributet kulturore dhe shkencore të tyre janë të njohura jo vetëm në Shqipëri, por edhe në shumë vende europiane e më tej. Ata kanë lënë gjurmë në tri fusha kryesore:

1. Në fushën e humanizmit (filozofi, histori, letërsi, teologji, folklor); Dhimitër Frëngu (1443-1525); Gjon Buzuku (shek. XVI); Marin Barleti (rreth viteve 1460-1512); Pjetër Budi (1566-1623); Frang Bardhi (1606-1643); Pjetër Bogdani (1625-1689) etj.;

2. Në fushën e artit (muzikë, pikturë dhe skulpturë); Jan Kukuzeli (1010-1075) - figura më e njohur në muzikë; Onufri (shek. XVI), piktori më i njohur; piktorët e shek. XVIII, David Selenicasi dhe Konstandin Shpataraku etj.;

3. Në fushën e shkencës, dijetarë si: Gjon Gazulli (1400-1465), astronom dhe matematikan; Leonik Tomeu (1456-1531), astronom, filozof dhe profesori i Nikola Kopernikut në Universitetin e Padovës etj.

Pushtimet e njëpasnjëshme penguan dhe dëmtuan zhvillimin kulturor dhe përparimin e vendit, por nuk mundën të ndërprisnin trashëgiminë kulturore dhe të tjetërsonin origjinalitetin e artit e të kulturës popullore shqiptare. Për shkak të këtyre rrethanave historike, shqiptarët mbetën prapa në zhvillimin e tyre kulturor dhe shkencor në krahasim me disa vende të tjera. Madje, edhe dëshmitë e para të rëndësishme të shkrimit shqip e të letërsisë shqipe, janë të shek. XVI (Gj. Buzuku 1555, L. Matrënga 1592), ndonëse shqipja është një nga gjuhët më të lashta indoeuropiane. Një traditë e shëndoshë letrare dhe kërkimesh shkencore mbi gjuhën dhe lashtësinë e kombit tonë u krijua tek Arbëreshët e Italisë, sidomos pas krijimit të Kolegjit të Palermos dhe Kolegjit të Shën Adrianit (në Shën Mitër të Kalabrisë), në vitet '30 të shek. XVIII. Veprat e Engjëll Mashit, Vinçens Dorsës, Dhimitër Kamardës, Jeronim De Radës etj., tërhoqën vëmendjen e botës shkencore dhe nxitën zhvillimin e studimeve shqiptare. Edhe tek Arvanitasit në Greqi zhvillohet interesimi për të ndriçuar shkencërisht historinë dhe gjuhën amtare dhe për të argumentuar kërkesat politike të popullit shqiptar (A.Kullurioti etj.). Rilindja Kombëtare (gjysma e dytë e shek. XIX), me përpjekjet e saj në luftën për liri e pavarësi, për të zgjuar ndërgjegjen kombëtare e për të afirmuar kombin dhe kulturën shqiptare, i dha një nxitje të madhe përparimit të mendimit shkencor mbi çështjet e gjuhës, historisë e traditave të popullit shqiptar; mbi përhapjen e arsimit në gjuhën amtare; njësimin e alfabetit të

gjuhës shqipe; lëvrimin dhe përpunimin e dijeve fillestare në degë të ndryshme të shkencës. Shumë figura të ndritura të kombit shqiptar, si Sami Frashëri, Hasan Tahsini, Refat Frashëri etj., megjithëse e zhvillonin veprimtarinë e tyre jashtë atdheut, u përpoqën jo vetëm për liri dhe pavarësi, por edhe për zhvillimin e arsimit, kulturës dhe shkencës shqiptare. Pas Shpalljes së Pavarësisë, në nëntor 1912, me përpjekjet e intelektualëve dhe të studiuesve më të njohur shqiptarë, u krijuan disa qendra kulturore dhe klube që kryenin edhe funksione studimore, në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Këto përpjekje të para për të krijuar shtratin e shkencës shqiptare, u shtuan dhe u bënë më të organizuara me konsolidimin e shtetit shqiptar, pas Kongresit të Lushnjës. U ngritën disa shërbime të veçanta, të cilat kryenin edhe ndonjë funksion studimor, si Shërbimi Veterinar ose Epidemiologjik (1928), ferma e Xhafzotajt e ndonjë tjetër. Edhe kërkues të huaj, si F. Nopça, H. Luis, F. Markgraf, A. Hajek, E. Durham, L. Rei etj., dhanë ndihmesën e tyre të çmuar për zhvillimin e studimeve shqiptare, duke çuar më tej traditën e studimeve albanologjike të shek. XIX. Gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore dhe më pas, u hulumtuan jo vetëm gjuha, etnologjia e historia e Shqiptarëve, por edhe gjeologjia e pasuritë natyrore, relievi, bimësia dhe u bënë hulumtime e gërmime arkeologjike. Në këto hulumtime e studime filluan të merrnin pjesë e të bashkëpunonin edhe specialistët shqiptarë që po përgatiteshin në universitetet e huaja. Gjuha shqipe dhe historia, arti e letërsia, traditat dhe kultura popullore, qenë fushat kryesore të kontributit të tyre vetjak. Kjo veprimtari shkencore nisi të marrë formën e vet më të plotë dhe të zhvillohej më tej gjatë viteve '30-'40, kur mjaft intelektualë të shkolluar jashtë vendit, hodhën themelet e studimeve shqiptare si: Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipo, Eqrem Çabej, Bilal Golemi, Gjovalin Gjadri, Hasan Ceka etj. Nje përpjekje e parë për të organizuar veprimtarinë shkencore u bë me krijimin e Institutit të Studimeve Shqiptare (1943), por në kushtet e luftës dhe të pushtimit, ky institucion nuk mundi të realizonte nxitjen dhe zhvillimin e kërkimeve shkencore. Pas Çlirimit të vendit u ngrit Instituti i Studimeve (1946), i cili u riorganizua si Institut i Shkencave (1948), dhe u bë vatra e parë e kërkimeve dhe e veprimtarisë shkencore të organizuar. Më 1957, u krijua Universiteti i Tiranës, i cili përfshiu edhe Institutin e Shkencave dhe hodhi bazat për përgatitjen e kuadrit shkencor për të gjitha fushat në vend. Duke filluar nga fundi i viteve '60 e më pas, për të përballuar një problematikë gjithnjë e më të gjerë, u ngrit një rrjet institucionesh shkencore më të specializuara për fusha të veçanta, disa prej tyre me theks me të spikatur zbatues. Puna e tyre hulumtuuese është pasqyruar në një varg revistash shkencore në gjuhën shqipe e në gjuhë të huaja, si dhe në përmbledhje joperiodike. Deri në vitin 1972, në vendin tonë vepronin 25 institucione kërkimore-shkencore. Në këto kushte, u bë e domosdoshme nevoja e ngritjes së Akademisë së Shkencave si një institucion kërkimor-shkencor kombëtar. Kështu, më 10 tetor 1972, me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor, u vendos krijimi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Mbledhja e parë e Asamblesë së Akademisë së Shkencave u mbajt më 25 janar 1973. Prof. Aleks Buda u zgjodh Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Midis themeluesve të saj spikatnin shkencëtarë të shquar si Eqrem Çabej, Mahir Domi, Kolë Popa etj. Në fillimet e saj, Akademia kishte 17 anëtarë të rregullt dhe 5 anëtarë korrespondentë; ajo funksiononte me një varg institutesh të shkencave shoqërore dhe albanologjike, si dhe të shkencave natyrore e teknike. Deri në fund të viteve '80, mbi veprimtarinë shkencore ndikuan një varg kufizimesh të karakterit jashtëshkencor, kryesisht të natyrës politike e ideologjike. Ato cënonin, sidomos fushën e shkencave shoqërore; kërkimet akademike impononin gjykime apriori, bëheshin pengesë për vlerësime objektive të disa arritjeve shkencore bashkëkohore e për zbatimin e tyre. Lidhjet ndërkombëtare të shkencëtarëve shqiptarë, pjesëmarrja në veprimtari ndërkombëtare, shkëmbimet shkencore dhe akademike, ndonëse nuk mungonin, ishin mjaft të kufizuara si pasojë e izolimit të vendit dhe të klimës politike.

Studimet shkencore të kryera nga institutet e Akademisë së Shkencave kanë zgjidhur një varg problemesh të rëndësishme të lidhura me njohjen e historisë, gjuhës e kulturës së popullit shqiptar; njohjen e natyrës e të pasurive natyrore të vendit; futjen dhe përdorimin e metodave dhe të

teknologjive të përparuara në prodhimin industrial e bujqësor; përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit e të shëndetit të popullsisë etj. Në fillim të vitit 2008, pas një reforme në kërkimin shkencor, institutet shkencore u shkëputën nga varësia e Akademisë. Sot Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka marrëdhënie bashkëpunimi me akademi shkencore kombëtare të rajonit dhe më gjerë në botë si: me akademinë e Austrisë, Britanisë së Madhe, Bullgarisë, Egjiptit, Italisë, Kinës, Kroacisë, Malit të Zi, Maqedonisë, Polonisë, Rumanisë, Ruisë, Sllovenisë, Turqisë. Bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës është shumë i ngushtë; me këtë institucion realizohen shumë veprimtari dhe studime të përbashkëta. Akademia e Shkencave e Shqipërisë është anëtare e disa organizmave shkencorë ndërkombëtarë si: Federata Europiane e Akademiave Kombëtare të Shkencave (ALLEA); Grupimi Interakademik (IAP); Akademia e Mesdheut; Akademia Europiane e Arteve, Shkencës dhe Lëndëve Humane; Akademia Botërore për të Drejtat e Njeriut; Qendra e Studimeve të Vendeve të Detit të Zi; Këshilli Ndërkademik për Europën Juglindore.

PJESA E PARE AKADEMIA E SHKENCAVE PAS REFORMIMIT

Përgatitja e raporteve vjetore të aktivitetit të institucioneve të sistemit të Shkencës dhe Teknologjisë, nuk duhet parë si një proces rutinë, por si një element i rëndësishëm për një analizë të thellë refleksioni, i asaj çka është bërë dhe për më tepër i asaj se çfarë duhet bërë për realizimin e funksionit të ligjshëm të ASH dhe për plotësimin e objektivave që burojnë nga misioni i saj.

Me ristrukturimin e sistemit të kërkimit shkencor, Akademia e Shkencave e Shqipërisë (AShSh) vepron nëpërmjet një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh të organizuar në seksione dhe nuk administron më institute/qendra kërkimi. Institutet e qendrat kërkimore të ASH, si edhe një pjesë e instituteve në varësi të ministrive të linjës u integruan në sistemin e arsimit të lartë, duke formuar qendra ndëruniversitare, fakultete, institute e qendra, si dhe departamente. Reformimi synoi që roli i ASH të mos dobësohet, duke marrë një rëndësi të veçantë dhe përgjegjësi në nivel kombëtar, në drejtim të kërkimit dhe edukimit, në sistemin e kërkimit shkencor e atë universitar.

DETYRAT KRYESORE TË AKADEMISË

- Akademia koordinon, mbështet dhe nxit kërkimin shkencor të anëtarëve të saj dhe në shkallë Republike.
- Nëpërmjet anëtarëve të saj dhe grupeve të specialistëve udhëheq projekte, kryen kërkime e studime me karakter teorik dhe të zbatuar në fusha të ndryshme të shkencave që mbulon, si dhe ndihmon për zbatimin e këtyre studimeve.
- Propozon për të hapur fusha të reja kërkimesh e studimesh shkencore në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit.
- U ofron institucioneve të larta shtetërore këshillimin dhe ekspertizën e nevojshme për zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme të zhvillimit të vendit, si edhe jep mendimin për hartimin e ligjeve që lidhen me shkencën.
- Bashkëpunon me institucione e qendra të tjera shkencore publike e private brenda vendit, për kryerjen e studimeve në fusha të ndryshme të shkencës.
- Vendos e zhvillon marrëdhënie bashkëpunimi me institucione shkencore të vendeve të tjera; ndihmon në bashkërendimin e veprimtarisë së organizmave të ndryshëm shkencorë, që mund të funksionojnë pranë saj, si dhe me organizata shkencore ndërkombëtare, për arritjen e një integrimi sa më të frytshëm të saj në shkencën botërore.

- Boton organe periodike të specializuara dhe vepra të tjera shkencore në të gjitha fushat e shkencës.
- Organizon kongrese e konferenca shkencore në shkallë kombëtare e ndërkombëtare.
- Kujdeset për rregullimin e raportit të zhvillimit të disiplinave shkencore dhe të përfaqësimit të tyre në Akademi në përputhje me nevojat e vendit dhe me arritjet e shkencave në fusha të ndryshme.
- Formon komisione e grupe pune të përhershme ose të përkohshme me rëndësi kombëtare në mbështetje të strategjive për kërkim e zhvillim, për organizimin e studimeve ndërdisiplinore me pjesëmarrjen e anëtarëve të saj dhe të studiuesve jashtë Akademisë.
- Organizon konkurse e dhënie çmimesh shkencore, lektoriume e promovime veprash, jep ose njuh patenta në kërkimin shkencor, koncepton e realizon me të drejtën e autorit emisione radio -tel evizive, mbledh dhe informatizon të dhënat e punës shkencore etj.
- Kujdeset për të drejtat e anëtarëve të vet, të gjithë akademikëve si dhe të punonjësve të tjerë shkencorë, për krijimin e kushteve të përshtatshme jetësore e materiale për veprimtari shkencore.

ORGANET DREJTUESE TË AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Organet drejtuese të Akademisë janë:

- 1. Asambleja**
- 2. Këshilli Ekzekutiv**
- 3. Kryesia e Akademisë**

Asambleja është organi më i lartë drejtues i Akademisë. Ajo mbledhet të paktën, dy herë në vit. Në Asamble kanë të drejtë vote vendimore sipas ligjit, anëtarët e rregullt, të përhershëm dhe të asociuar të Akademisë.

- Asambleja shqyrton dhe miraton drejtimet kryesore të veprimtarisë shkencore të Akademisë;
- vendos për çështje të tjera të rëndësishme me karakter shkencor e organizativ;
- miraton Statutin dhe ndryshimet që mund të bëhen në përmbajtjen e tij;
- zgjedh anëtarët e rinj të rregullt, të përhershëm, të asociuar e të nderit; zgjedh Kryesinë dhe kryetarët e seksioneve;
- shqyrton dhe miraton raportet e Kryesisë mbi veprimtarinë e përgjithshme të Akademisë;
- shqyrton probleme të zhvillimit perspektiv të shkencave në vend dhe u paraqet propozime organeve përkatëse.

Të gjitha çështjet zgjidhen nga Asambleja me votim të hapur dhe me shumicën e anëtarëve të pranishëm, përveç rasteve kur në Statut parashikohet ndryshe.

Asambleja zgjedh me votim të fshehtë, për një mandat katërvjeçar kryetarin e Akademisë dhe zëvendëskryetarin dhe, për një mandat pesëvjeçar, sekretarin shkencor dhe kryetarët e seksioneve. Kryesia e Akademisë përbëhet nga tre anëtarë të Asamblesë: Kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari shkencor.

Kryesia e Akademisë organizon, drejton dhe bashkërendon veprimtarinë e Akademisë;

- vendos marrëdhënie e lidh marrëveshje bashkëpunimi me institucione vendëse e të huaja;
- vendos për mbledhjen e Asamblesë; miraton ndarjen e kuotave të buxhetit sipas fushave të veprimtarisë së Akademisë.

Kryesia e Akademisë ka aparatin e vet, i cili funksionon sipas rregullores së miratuar prej saj.

Kryetari i Akademisë përfaqëson Akademinë në marrëdhëniet e saj me institucionet e vendit dhe të shteteve të tjera, siguron lidhjet me organet shtetërore, thërret dhe drejton mbledhjen e Asamblesë, të Këshillit Ekzekutiv dhe të Këshillit të Botimeve.

Në gjithë veprimtarinë dhe ushtrimin e funksioneve të tij kryetari ndihmohet nga zëvendëskryetari dhe sekretari shkencor. Në rast mungese të kryetarit, zëvendëskryetari e zëvendëson në të gjitha funksionet e tij.


Zëvendëskryetari ndjek e bashkërendon punën e seksioneve, miraton programet e veprimtarisë së tyre kryesore-organizative dhe ndihmon për mbarëvajtjen e tyre.

Sekretari Shkencor ndjek zbatimin e vendimeve të Asamblesë, të Këshillit Ekzekutiv dhe të Kryesisë, përgatit mbledhjet e tyre, kujdeset për paraqitjen e programit shkencor të Akademisë dhe të raporteve për veprimtarinë e përgjithshme të saj, sipas programeve dhe raporteve të paraqitura nga seksionet e organizmat e tjerë, mbikëqyr veprimtarinë e aparatit administrativ të Akademisë.

Këshilli Ekzekutiv përbëhet nga 5 anëtarë: kryetari, zëvendëskryetari, sekretari shkencor i Akademisë dhe kryetarët e seksioneve. Kryetari i Akademisë është edhe kryetar i Këshillit Ekzekutiv.

- Këshilli Ekzekutiv zbaton vendimet e Asamblesë;
- Shqyrton probleme të rëndësishme shkencore e organizative dhe merr vendimet përkatëse.
- Për gjithë veprimtarinë e tij, Këshilli Ekzekutiv raporton para Asamblesë.

Struktura organizative e AShSh pas reformimit paraqitet në skemën e mëposhtme



ANËTARËSIMI NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Akademia ka në përbërje:

- anëtarë të rregullt,
- anëtarë të përhershëm,
- anëtarë të asociuar dhe
- anëtarë nderi.

Anëtarët e rregullt dhe të përhershëm të Akademisë mbajnë titullin “Akademik”, të cilin e ruajnë edhe pas daljes në pension. Ata janë jo më shumë se 30 veta. Anëtarë të përhershëm janë deri në 10 veta. Titulli “Akademik” është titull shkencor vetjak.

Anëtarët e asociuar të Akademisë janë jo më shumë se 15 veta dhe mbajnë titullin “Akademik i asociuar”.

Anëtarët e rregullt të Akademisë zgjidhen nga radhët e shkencëtarëve të shquar me titull “Profesor”, që janë edhe anëtarë të asociuar të Akademisë, që kanë ose kanë pasur shtetësi shqiptare, që nëpërmjet punimeve origjinale e veprave përgjithësuëse me një nivel të lartë shkencor kanë zgjidhur teorikisht e praktikisht probleme të një rëndësie të veçantë në fushën e shkencës, të ekonomisë, të artit dhe të kulturës, si edhe kanë dhënë kontribute të veçanta në formimin universitar e pasuniversitar të shkencëtarëve të rinj. Anëtarë të rregullt të Akademisë zgjidhen edhe nga radhët e shkencëtarëve të shquar shqiptarë, që nuk e kanë fituar titullin “Profesor” në Shqipëri, por kanë gradën shkencore “PhD” ose “Doktor”, të cilët punojnë aktualisht pranë universiteteve ose pranë qendrave kërkimore jashtë vendit dhe kanë kontribute akademike, që tejkalojnë parashikimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi për kërkimin e titullit “Profesor”. Pas plotësimit të numrit të caktuar, pranimi i anëtarëve të rinj bëhet vetëm për vendet e lira, por jo detyrimisht nga fushat ku janë krijuar vendet e lira.

Në raste të veçanta, anëtarë të rregullt të Akademisë mund të zgjidhen personalitete edhe pa titullin “Profesor”, që kanë merita të shquara në fusha të ndryshme të krijimtarisë letrare e artistike.

Anëtarët e përhershëm të Akademisë zgjidhen nga akademikët që kanë mbushur moshën 75 vjeç dhe kanë kontribute të shquara, të vlerësuara gjerësisht në shkallë kombëtare e ndërkombëtare.

Anëtarët e asociuar të Akademisë zgjidhen nga radhët e shkencëtarëve me titull “Profesor”, që kanë ose kanë pasur shtetësi shqiptare, të cilët nëpërmjet punimeve e veprave shkencore kanë dhënë kontribute të rëndësishme në zhvillimin e shkencës dhe në formimin universitar e pasuniversitar të shkencëtarëve të rinj. Anëtarë të asociuar të Akademisë zgjidhen edhe nga radhët e shkencëtarëve të shquar shqiptarë që nuk e kanë fituar titullin “Profesor” në Shqipëri, por kanë gradën shkencore “PhD” ose “Doktor” dhe punojnë aktualisht pranë universiteteve ose pranë qendrave kërkimore jashtë vendit, si edhe kanë kontribute akademike që tejkalojnë parashikimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi për kërkimin e titullit “Profesor”. Pas plotësimit të numrit të caktuar pranimi i anëtarëve të rinj të asociuar bëhet vetëm për vendet e lira, por jo detyrimisht nga fushat ku janë krijuar vendet e lira.

Anëtarët e nderit zgjidhen nga radhët e personaliteteve të njohura të vendeve të tjera, të cilët kanë dhënë kontribute të shquara në kërkimin shkencor në dobi të zhvillimit të vendit tonë.

Funksionarët e lartë të administratës shtetërore dhe të partive politike nuk mund të kandidojnë për t’u zgjedhur anëtarë të rregullt ose të asociuar të Akademisë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

Akademia ka 42 anëtarë, nga të cilët 28 anëtarë të rregullt, akademikë, 14 anëtarë të asociuar, si edhe 26 anëtarë nderi. (*Listat me emrat sipas ndarjes së mësipërme paraqiten në Shtojcën 3*).

SEKSIONET E AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Seksionet janë njësi shkencore, të cilat në përshtatje me vendimet e Asamblesë, të Këshillit Ekzekutiv dhe të Kryesisë së Akademisë, realizojnë detyrat e përcaktuara në Ligjin dhe në Statutin e Akademisë. Seksionet ndahen në:

1. Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike

2. Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike

- Ato orientojnë, organizojnë, bashkërendojnë dhe ndjekin veprimtarinë shkencore në fushat e shkencave që mbulojnë;
- ndjekin gjendjen dhe zhvillimin e këtyre shkencave;
- studiojnë dhe paraqesin perspektivat e zhvillimit të tyre;
- bëjnë propozime për ngritje institutesh e qendrash shkencore; për ngritje grupesh të veçanta për studime ndërdisiplinore; për ngritje komisionesh studimi për probleme të caktuara të rëndësishme, duke aktivizuar edhe specialistë të jashtëm;
- bëjnë propozime dhe marrin masa për organizime kongresesh, konferencash, simpoziumesh e seminaresh shkencore me karakter kombëtar e ndërkombëtar me tematikë ndërdisiplinore;
- caktojnë kriteret themelore për botimet akademike të profilit të tyre; botojnë revista shkencore të specializuara, redaksitë e të cilave funksionojnë pranë këtyre seksioneve;
- përcaktojnë kërkesat financiare për botime;
- diskutojnë e japin mendime për botimin e veprave akademike të fushave përkatëse;
- shqyrtojnë zbatimin e kërkesave e të aplikimeve dhe japin mendim paraprak për kandidatët që aplikojnë për akademikë të rregullt e të asociuar.

Seksioni përbëhet prej anëtarëve të rregullt, anëtarëve të përhershëm dhe anëtarëve të asociuar të Akademisë. Seksioni drejtohet nga kryetari i tij. Kryetari i Seksionit thërret dhe drejton mbledhjet e Seksionit.

NJËSIA E PROJEKTEVE TË KËRKIMIT, ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK DHE INOVACIONEVE

Njësia e Projekteve të Kërkimit, Zhvillimit Teknologjik dhe Inovacioneve synon, mbi të gjitha:

- nxitjen e kërkimit shkencor, brenda dhe jashtë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë;
- forcimin e bashkëpunimit institucional, kombëtar dhe rajonal si pjesëmarrës apo si koordinator i ASh në programe e projekte kombëtare, rajonale dhe më gjerë;
- krijimin e grupeve *ad hoc* për kërkime shumëdisiplinore;
- nxitjen e krijimit të rrjeteve të kërkimit, komunikimit e shkëmbimit të informacionit dhe të përhapjes së përvojës më të mirë në zhvillimin teknologjik të kërkimit e të risive.

Kjo njësi vepron në nivel akademik dhe bashkëpunon ngushtë me dy seksionet e tjera të saj, duke i ndihmuar ato, mbi të gjitha, në proceset e ideimit e të aplikimit, në kuadër të programeve të kërkimit e zhvillimit dhe në forcimin e partneritetit me institucione të tjera kërkimore brenda dhe jashtë vendit.

BIBLIOTEKA SHKENCORE

Biblioteka e Akademisë së Shkencave është krijuar në vitin 1975, njëherazi me krijimin e Akademisë së Shkencave. Biblioteka e Akademisë ka karakter special. Ajo kryen një shërbim me cilësi të lartë për kërkimin shkencor, duke zhvilluar dhe ofruar një informacion të gjerë dhe shumëdisiplinor jo vetëm në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të tjera. Ajo konsiderohet qendra kryesore e informimit të mirëfilltë shkencor në Shqipëri.

Biblioteka ka një trashëgimi të pasur prej rreth 180 000 vëllimesh dhe shumë periodikë, të cilët mbulojnë të gjitha subjektet e kërkimit shkencor në institutet e saj.

Me vlerë të posaçme janë sidomos, traktatet gjuhësore të autorëve shqiptarë dhe punimet origjinale të albanologëve të huaj, si dhe vepra origjinale të Arbëreshëve dhe Arvanitasve. Materiali është kataloguar sipas Klasifikimit Dhjetor (KDU) dhe rregullave anglo-amerikane të katalogimit (AACR2). Në BASH është instaluar programi CDS/ISIS dhe ka filluar katalogimi i automatizuar i hyrjeve të reja. Shumë shpejt kjo bibliotekë do të ketë shërbimin e shfrytëzimit të katalogut elektronik (*online*).

BASH është anëtarësuar në IFLA dhe bashkëpunon, sidomos në sektorin e shkëmbimit bibliotekar, me shumë biblioteka në botë. Ajo boton një buletin periodik të hyrjeve të reja, si dhe është qendër e organizimit të seminareve dhe takimeve të ndryshme me karakter shkencor.

Ajo kryen të gjithë korrespondencën në lidhje me shkëmbimet e literaturës, brenda dhe jashtë vendit.

DEGA E MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE PUBLIKUN

Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka marrëdhënie të shumta brenda dhe jashtë vendit. DMJP bashkëpunon ngushtë me institucionet e sistemit të kërkimit shkencor e universitar në Shqipëri. Ajo, sipas detyrave që i jepen nga organet drejtuese, bashkëpunon me institucionet qeveritare, përfaqësitë e huaja e organizatat ndërkombëtare në vend.

DMJP bashkëpunon me akademi shkencore kombëtare të rajonit si dhe me akademi të tjera të botës. Ajo ka marrëdhënie bashkëpunimi me: Austrinë, Britaninë e Madhe, Bullgarinë, Egjiptin, Italinë, Kinën, Kroacinë, Malin e Zi, Maqedoninë, Poloninë, Rumaninë, Rusinë, Slloveninë, Turqinë.

Me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës realizohen shumë veprimtari dhe studime të përbashkëta.

DMJP zhvillon veprimtari me disa organizma shkencore ndërkombëtare, ku Akademia e Shkencave e Shqipërisë është anëtare, si:

- Federata Europiane e Akademive Kombëtare të Shkencave (ALLEA); Grupimi Interakademik (IAP);
- Akademia e Mesdheut;
- Akademia Europiane e Arteve, Shkencës dhe Lëndëve Humane;
- Akademia Botërore për të Drejtat e Njeriut;
- Qendra e Studimeve të Vendeve të Detit të Zi;
- Këshilli Ndërkademi për Europën Juglindore.

DEGA E FINANCËS DHE ADMINISTRATËS

Në ASH funksionon Dega e Financës dhe Administratës, e cila mbështet veprimtaritë ekonomike. Akademia është institucion buxhetor dhe të ardhurat i siguron nga:

1. Buxheti i shtetit.
2. Pjesëmarrja në projekte; gjithashtu, të ardhura nga dhuratat, subvencionet e sponsorizimet.
3. Shërbime tekniko-shkencore, që kryhen për persona juridikë e fizikë jashtë sistemit të saj.

Të ardhurat e krijuara sipas pikave 1 dhe 2 përdoren në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Çdo akademik mund të aplikojë për mbështetje nëpërmjet projekteve të kërkimit e zhvillimit. Sektori ekonomik mbështet Njësinë e Projekteve të Kërkimeve e Zhvillimit Teknologjik dhe Inovacioneve, si dhe të gjitha strukturat e Akademisë së Shkencave në veprimtaritë ekonomike dhe financiare.

VEPRIMTARITË E AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË GJATË VITIT 2009

Gjatë vitit 2009, në veprimtaritë e saj AShSh ka synuar realizimin e funksioneve kryesore të saj:

- krijimin e një infrastrukture të përshtatshme, me standarde e në përputhje me strukturën pas reformimit të ASh, për zhvillimin e veprimtarisë efektive, në përputhje me funksionet për përmbushjen e misionit të saj;
- bashkëpunimin me institucionet qeveritare në identifikimin e problematikave për angazhimin e ASh në realizimin e objektivave të Qeverisë;
- këshillimin dhe ekspertizën e nevojshme për institucionet politikëbërëse dhe vendimmarrëse;
- bashkëpunimin me institucionet kërkimore dhe mësimore, brenda dhe jashtë vendit, për kryerjen e studimeve në fusha të ndryshme të shkencës e teknologjisë;
- propozimin e fushave të reja të kërkimit e studimit, në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik e social të vendit;
- botimin e organeve periodike dhe veprave të tjera me nivel të lartë shkencor;
- organizimin e kongreseve dhe konferencave shkencore dhe problemore në shkallë kombëtare e ndërkombëtare;
- organizimin e konkurseve dhe dhënien e çmimeve shkencore;
- Promovimin dhe mbështetjen e ekselencës e kërkuesve të rinj në shkencë në shkallë kombëtare, për të realizuar nivele të lartë kërkimi dhe për të krijuar e mbështetur strukturat e saj të përfaqësimit.

Vëmendje i është kushtuar studimit të analizave të BE, lidhur me zhvillimet e ShT në vendet e Ballkanit Perëndimor e situatën e kërkimit në Shqipëri e rajon, dhe mangësitë kryesore të Sh&T, të tilla si:

1. Mbizotërimi i sektorit publik mbi atë privat në Sh&T;
2. Mungesa e integritetit ndërmjet agjendave të kërkimit dhe politikave të tjera;
3. Mungesa e fondeve;
4. Përfshirja e pamjaftueshme e sektorit privat në Sh&T apo mungesa e marketimit të arritjeve të shkencës dhe teknologjisë;
5. Mungesa e mekanizmave nxitës për rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar;
6. Zhvillimi dhe aplikimi i pamjaftueshëm i strategjive dhe ligjeve në Sh&T.

Në analizën e paraqitur për aktivitetin e AShSh gjatë vitit 2009 jemi përpjekur që të sjellim një raport analitik. Të jesh analitik, do të thotë të vendosësh indikatorë të përpiktë, të matshëm dhe të krahasueshëm, për ta parë zhvillimin me sy realist dhe në mënyrë dinamike. Një nga metodat random për ta parë zhvillimin në mënyrë dinamike është ajo e krahasimit të treguesve me ato të viteve të mëparshme. Kjo metodë nuk mund të përdoret në rastin e ASh për të gjithë treguesit, mbas reformës (në kushtet pa institucione kërkimore në varësi). Për këtë arsye, në analizën tonë kemi realizuar, për herë të parë, kriteret dhe treguesit ndërkombëtarë, të përcaktuara në “Manualin e Fraskatit”. Si fillim kemi përcaktuar pesë grupe treguesish të lidhur me (i) aktivitetin kërkimor (bazë, aplikativ apo eksperimental); (ii) fushat e kërkimit; (iii) personelin dhe (iv) shpenzimet. Domosdoshmëria e përcaktimit të këtyre indikatorëve cilësorë dhe sasiorë në ASh, buron dhe nga

etë roli që produktet e saj të KZh, (si të një institucioni elitari në kërkim – zhvillim e inovacione), duhet të luajnë në zhvillimit ekonomik e social të vendit.

Përbërja e AShSh ka pësuar reformim thelbësor. Komponenti më i rëndësishëm i këtij reformimi është riformatimi i Asamblesë së Akademisë, mbi bazën e konkurrimit shkencor të mbikqyrur nga 4 akademikë të përzgjedhur shqiptarë dhe 5 ekspertë të huaj. Si rrjedhojë, u përzgjedh Stafi Akademik që sot përbëhet nga 28 Akademikë (1 i përhershëm) dhe 14 Akademikë të Asociuar të shpërndarë sipas fushave të kërkimit, si në diagramën e mëposhtme:




Fig. 2. Struktura e stafit akademik të ASh sipas fushave

Siç shihet stafi akademik mbizotërohet nga ata të shkencave humanitare dhe albanologjike (44%), më pas vijnë shkencat natyrore (29%) dhe më pak në shkencat bujqësore (3%) e shoqërore (5%). Duke e parë në aspektin e seksioneve, ka një ndarje të barabartë (50% secili) në numrin e akademikeve.

Një indikator i përdorur nga institucionet ndërkombëtare është ai i strukturës së moshës. Bazuar në klasat e moshës, stafi akademik paraqitet si më poshtë.




Fig. 3. Stafi akademik sipas klasave të moshës

Dominimi i klasave të moshës së madhe ka një vlerë komplekse dhe konsiderohet normal për rolin dhe misionin e AShSh, megjithatë ne duhet të synojmë të rekrutojmë në gjirin e akademikëve kërkues me vlera, me moshë relativisht të re; për këtë qëllim AShSh, në përputhje edhe me nismat e akademive të botës, po përpunon strategji të reja për afrimin dhe mbështetjen e kërkuesve të rinj në shkencë. Krijimi i një strukture të re në formën e një forumi të kërkuesve të rinj, do të jetë përparësi për AShSh në vitin 2010 e në vazhdim.

Për sa u përket treguesve ekonomikë, të lidhur me burimet financiare të ASHSH, të cilat gjatë vitit 2009 kanë qenë rreth 88.652.000 Lekë (~653.776 EURO), mund të analizohen si më poshtë:




Fig. 4. Burimet e financimit

Burimet e financimit vijnë kryesisht nga buxheti i shtetit (85%) dhe vetëm (15%) nga projekte ndërkombëtare, ndërkohë që risia e ASHSH gjatë viti 2009 ka qenë afrimi i sektorit privat për donacione të ndryshme për investime në infrastrukturë, në shënimin e ngjarjeve, dhënie çmimesh etj.

Tregues të tjerë janë edhe ata të sistemit të balancës së treguesve monetarë për vitin 2009, të cilët paraqiten si më poshtë:

	000/lekë
Tipi i kostos	2009
Kostot e punës	55889
Kostot e tjera të vijueshme	7996
Trualli dhe Godinat	3450
Instrumentet dhe Pajisjet	460
Totali	67795




Fig. 5. Balanca e treguesve monetarë

Veprimtarinë e saj, AShSh e zhvillon përmes Seksioneve të saj, përkatësisht të Shkencave Natyrore e Teknike dhe të Shkencave Shoqërore e Albanologjike.

Për të dy Seksionet, në kushtet e reja pas ripërtëritjes së ASH-së, është punuar për përcaktimin e kuadrit të prioriteteve të veprimtarive për kërkim e zhvillim, që ato t'i përgjigjen më së miri zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit. Objektivi i AShSh ka konsistuar në vazhdimësi në përmbushjen e prioriteteve shkencore afatshkurtër, afatmesëm e ato perspektive dhe mobilizimin e shkencëtarëve. Objektivat e AShSh janë në përputhje me Strategjinë për Shkencën, Zhvillimin Teknologjik e Inovacioneve në rang kombëtar.

Kërkimi në fushat shoqërore e albanologjike është zhvilluar me përparësi në zgjidhjen e problemeve ekonomike, gjuhësore dhe ruajtjen e vlerave të trashëgimisë historike e kulturore, shoqërore, demografike etj. Me veprimtaritë e saj ajo ka synuar realizimin e një qëllimi të rëndësishëm: kontributin në formimin e një shoqërie civile cilësore, me mentalitet demokratik, e aftë të përballojë sfidat e integritit dhe angazhimit të Shqipërisë në familjen e madhe evropiane, rritjen e kualitetit të jetës etj.

Kërkimi në fushat natyrore e teknike është zhvilluar me përparësi në fushat e teknologjive të informimit e komunikimit, shëndetit publik, eficiencës energjetike, biodiversitetit, mjedisit etj., të lidhura e në përputhje me Programet Kombëtare për Kërkim dhe Zhvillim (PKKZh).

Forcimi i kapaciteteve të ASH, e aftë për këshillim të qeverisjes dhe shoqërisë civile, është një domosdoshmëri për zhvillimin e vendit. Ajo është në përputhje edhe me prioritetet e InterPanelit të Akademive të Botës (ALLEA) me fokus forcimin e kapaciteteve këshilluese të saj për kërkim shkencor e zhvillim në arritjen e treguesve të anëtarësimit në Europë.

Bazuar në fushat prioritare për zhvillimin e vendit, AShSh ka punuar për krijimin e komisioneve të përhershme apo ad-hoc, duke tërhequr specialistët më të mirë të fushave, për të realizuar studime të rëndësishme së veçantë, kombëtare e më gjerë, të cilat vihen në shërbim të vendimmarrësve. Kësisoj, pas kryerjes me sukses të Konferencës së leksikologjisë së gjuhës shqipe të zhvilluar në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, u ngrit komisioni *ad-hoc* për Terminologjinë e Gjuhës Shqipe. Të tilla komisione do të ngrihen hap pas hapi edhe për fushat të tjera, me synimin që ato të jenë shumëdisiplinore: për fushën e arsimit, ujit, energjisë, emergjencave civile, bujqësisë dhe ushqimit, biodiversitetit, cilësisë së jetës, mjedisit, gjuhësisë, historisë, trashëgimisë kulturore, sociologjisë, ekonomisë, financës, problemeve demografike etj. Këto komisione do të udhëhiqen nga akademikë të shquar e specialistë të fushave, që zhvillojnë veprimtarinë e tyre brenda e jashtë vendit.

Promovimi i ngjarjeve të mëdha dhe i figurave më të shquara të kombit, i vlerësimit edhe i figurave të sotme, të cilat do të analizohen në hollësi për secilin nga Seksionet, ka qenë një tjetër objektiv.

Rritja e bashkëpunimit kombëtar e ndërkombëtar, realizimi i marrëveshjeve e protokolleve me institucione kërkimore shkencore e universitare dhe prezantimi i denjë i AShSh në takime ndërkombëtare, kanë qenë në fokus të veprimtarisë së Akademisë. Duhet përmendur këtu edhe një sërë takimesh e kontaktesh me kërkues e personalitete të kërkimit shkencor, ku është diskutuar për çështje me interes reciprok dhe janë finalizuar marrëveshje, të cilat do të trajtohen më poshtë sipas njësive përkatëse.

Përpjekje të konsiderueshme janë bërë në drejtim të pjesëmarrjes së ASh në Programet Kuadër të BE apo programe të tjera me karakter kërkimor, ku Akademia përfaqësohet dhe jep kontribut në rang ekspertësh në disa nga programet më të rëndësishme si, Transporti dhe Aeronautika, Teknologjitë e Informacionit, Siguria, Bioteknologjia dhe Ushqimi, Shëndeti, Kërkimi dhe Teknologjitë etj.

Janë realizuar treguesit e buxhetit të vitit 2009 dhe për vitet në vazhdim, një buxhet i bazuar në projekte për një veprimtari ambicioze kërkimore-shkencore është parashikuar në bazë të një projektbuxheti të kërkuar së fundmi nga Qeveria. Projektbuxheti është përgatitur nga kryesitë e Seksioneve, Njësia e Projekteve, Dega e Financës dhe i gjithë stafi i institucionit në përputhje me të gjitha udhëzimet e Ministrisë së Financave. Theksojmë se ky lloj planifikimi buxhetor me tregues të rinj është përgatitur për herë të parë në Akademi. Programi 2010-2013 është miratuar në Këshillin Ekzekutiv të ASh. Gjithashtu për këtë qëllim, ka pasur mbi 5 seanca konsultative me ekspertë të buxhetimit në Ministrinë e Financave, për kërkesat tona për mbështetjen e veprimtarive në të gjitha zërat si Marrëveshjet me Akademitë, Qendra Kërkimore Ndërkombëtare (si CNR, Itali, etj.), projekte dhe konferenca brenda dhe jashtë vendit, mbështetje të Seksioneve, grupeve multidisiplinore ad-hoc dhe akademikëve për veprimtari të ndryshme etj.

Një rëndësi të veçantë kanë marrë veprimtaritë që lidhen me marrëdhëniet e AShSh në planin ndërkombëtar. AShSh bashkëpunon me institucionet homologe e më gjerë, si me Rrjetin e Akademive të Botës (ALLEA), me Rrjetin e Akademive të Europës, InterPanelin e Akademive (IAP), Rrjetin e Akademive të Vendeve të Botës së Tretë (TWAS), si dhe organizmat shkencorë CNR-Itali, ato të Kombeve të Bashkuara etj. Do të vazhdojë puna për konkretizimin së shpejti të Marrëveshjes me Akademinë e Bujqësisë dhe Pyjeve të Suedisë, të Marrëveshjes me CRDF-USA, të konkretizimit të projekteve në programe të ndryshme të filluara gjatë vitit 2009 etj.

Objektiv i veçantë konsiderohet bashkëpunimi me jashtë në ndihmë të lidhjeve, njohjes e integritimit të Shqipërisë në bashkësinë europiane e lidhjet e saj në botë nëpërmjet rritjes cilësore të bashkëpunimeve në fusha të kërkimit shkencor në shkencat shoqërore e natyrore-technike. AShSh ka objektiv partneritetin në 5 fusha të iniciativës së Programit “ERA” (European Research Area), që konsistojnë në:

1. bashkëpunimin ndërkombëtar në shkencë dhe teknologji;
2. intensifikimin e partneritetit në kërkim;
3. transferimin e teknologjive;
4. kërkimet në infrastrukturë;
5. zhvillimet më të reja në shkencë etj.

Gjatë vitit 2009, AShSh ka iniciuar disa lidhje të rëndësishme në nivel botëror dhe evropian:

- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me IAP dhe mbështetja nga ana e tij me konsulta e grante në procesin e reformimit të AShSh për ngritjen e forcimit e kapaciteteve në infrastrukturë etj.

- AShSh përfaqësohet në Këshillin Ndërkombëtar të Shkencës me qendër në Paris. Pas aplikimit, Këshilli zgjodhi dhe kandidaturën shqiptare nga AShSh. Oponenca u realizua nga institucione prestigjioze ndërkombëtare, si edhe nga Këshilli Kombëtar për Shkencën e Italisë (CNR).

- AShSh është përfshirë në Komitetin Ekzekutiv të Shoqatës Ndërkombëtare të Oqeanografisë Biologjike.

- AShSh nënshkroi deklaratën e një Programi Ndërkombëtar për studimin e acidifikimit të ujërave oqeanike e të zvogëlimit të ndotjes së gazit karbonik në hapësirë.

- AShSh është anëtare e AIESEE, e cila në 23-26 shtator 2009 - Kongresi i 10^{të} Ndërkombëtar i AIESEE, zgjodhi si kryetar të saj të radhës, Akademik Prof. Luan Omarin.

- Akad. Salvator Bushati u zgjodh anëtar i Akademisë Europiane të Shkencave dhe Arteve (4 dhjetor 2009).

- Që prej vitit 2009, Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike i AShSh, është anëtar i Projektit Ndërkombëtar të Studimeve Degjeneruese të Trurit: sëmundjes së Alzheimer-it.

- AShSh përfaqësohet edhe në “Nismën e Transparencës në Industrinë Nxjerrëse”, një detyrim lidhur me nismave e BE, që po zbatohet edhe në Shqipëri, që prej vitit 2009.

- Në vitin 2009 midis AShSh dhe Universitetit të Barit, Itali u nënshkrua Marrëveshja për bashkëpunim tekniko-shkencor në ndjekjen e studimeve “Doktoraturë në Kërkimet Gjeomorfologjike dhe Dinamike të Mjedisit”.

- U pranua aplikimi i AShSh për anëtarësim në UEAA (Union of European Agrarian Academies).

Kërkesës së paraqitur nga Kryetari i ASh, Akad. Gudar Beqiraj 24 akademive të botës, nëpërmjet një qarkoreje për të ndihmuar Akademinë tonë në drejtim të ri-orientimit të procesit kërkimor, të forcimit të aspekteve organizative të Akademisë dhe të mbështetjes financiare për zgjerimin e veprimtarive të reja të saj, i janë përgjigjur pozitivisht Akademitë e Spanjës, Portugalisë, Hungarisë, Bullgarisë, Serbisë, Lincei - Itali, ALLEA dhe IAP. Për të programuar më në hollësi bashkëpunimin me to, Kryetari i AShSh është ftuar të bëjë vizita pune në Akademitë e Sllovenisë, Gjermanisë - Leopoldina dhe të Turqisë.

PJESA E DYTË

VEPRIMTARITË E SEKSIONEVE TË AShSh-së

A. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE DHE ALBANOLOGJIKE

Gjatë viti 2009 vëmendja e Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike u përqendrua në trajtimin e problemeve të rëndësishme, kryesisht në fushën e albanologjisë, gjuhësisë e letërsisë, arkeologjisë, etnografisë e muzikologjisë si dhe në atë të shkencave shoqërore.

Në përparësitë e Seksionit kanë qenë veprimtaritë me karakter shkencor ndërkombëtar dhe veçanërisht mbarëkombëtar, të para ato si tribuna të mendimit shkencor albanologjik shqiptar. Në këtë drejtim veprimtaritë madhore të Seksionit janë zhvilluar në bashkëpunim me akademitë e shkencave të vendeve ku banojnë shqiptarë, përkatësisht me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Republikës së Kosovës, Republikës së Maqedonisë dhe më tej me atë të Malit të Zi.

Në përshtatje me funksionin e ri të Akademisë, Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjisë, ka synuar në:

- krijimin e skemave të reja të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimtarisë shkencore me Qendrën e Studimeve Albanologjike (QSA) dhe institucioneve të tjera shkencore në vend;

- intensifikimin e marrëdhënieve me seksionet përkatëse të akademive të tjera, veçanërisht me ato të Kosovës dhe Maqedonisë;

- ndjekjen me përparësi të projekteve të emërtesës të Këshillit të Ministrave, Programit Kombëtar për Kërkim dhe Zhvillim dhe atyre të Akademisë Shkencave;
- krijimin e lidhjeve organike me fakultetet e profilit shoqëror, kulturor dhe albanologjik të universiteteve;
- krijimin dhe stimulimin e rrjetit të bashkëpunëtorëve të seksionit, në radhë të parë me pjesëtarë të stafit akademik;
- organizimin e konferencave shkencore të profilit albanologjik;
- ndjekjen e botimeve të specializuara shkencore;
- propagandimin mediatik të veprimtarisë akademike dhe ngjarjeve që lidhen me historinë, gjuhësinë, kulturën materiale shqiptare etj.

B. SEKSIONI I SHKENCAVE NATYRORE DHE TEKNIKE

Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike në vitin 2009 ka pasur si prioritete veprimtari në fusha të tilla si teknologjitë e informimit e komunikimit, shëndetësia dhe shërbimi parësor, rregullimi i regjimit ujor në liqene, lumenj e laguna, shfrytëzimi i energjisë së rinovueshme (gjeotermale, nga biomasa etj.), vlerësimi, ruajtja dhe rehabilitimi i ekosistemeve natyrore, përdorimi i metodave të rrezatimit jonizues për sigurinë ushqimore, biodiversiteti dhe cilësia e ushqimit etj. Këto veprimtari janë iniciuar në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Shkencor me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Programeve Kombëtare për Kërkim dhe Zhvillim të MASH, Programeve GEF/PNUD, REC, si dhe nëpërmjet punës individuale të akademikëve në sektorët ku punojnë.

Kështu AShSh ka qenë aktive në takimet e zhvilluara nga organizmat shtetërorë lidhur me katastrofat natyrore të ndodhura në Veri të Shqipërisë. Në përgjigje të kërkesës së Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Akademia e Shkencave po bashkëpunon për hartimin e prioriteteve për rehabilitimet në zonat e përmytura, zbatimin e kontrollit dhe monitorimit të digave, kupave të rezervuarëve dhe sigurisë së shpateve. Janë paraqitur disa propozime, të cilat pritet së shpejti të vlerësohen për t'u vënë në jetë nga MMPAU.

Në kuadër të Bashkëpunimit me Panelin Ndërkombëtar të Akademive të Botës (Inter-Academy Panel, IAP) po realizohet projekti i rëndësishëm për fuqizimin e AShSh e të strukturave të saj në procesin e reformimit, që përfshin mbështetje dhe konsulencë nga Akademitë e vendeve të tjera.

Seksioni ka pasur si prioritet edhe bashkërendimin e zhvillimin e projekteve të niveleve të ndryshme Europiane EU-FP6 dhe FP7, INTERREG III, SCOPES, SEE-ERA.NET, WBC-INCO.NET, IS2WBC, SCORE, Natural SEE, TWAS, etj. me pjesëmarrjen edhe të kërkuesve prej universiteteve e institucioneve kërkimore në vend. Në përputhje me prioritetet, me strategjitë, politikat e kërkim-zhvillimit dhe nismat e BE dhe në interes për përmbushjen e objektivave kombëtarë të kërkim-zhvillimit, AShSh ka luajtur rolin e ideuesit të projektit, hartuesit të propozimit apo koordinatorit, në trajtimin e problemeve të rëndësishme të kërkim-zhvillimit, trajnimin e shkencëtarëve të rinj lidhur me administrimin dhe zhvillimin e Programeve Europiane (TRAINASA), të projekteve të kërkimit shkencor ndërkombëtar, të studimeve për ngritjen e strukturave e institucioneve të reja kërkimore shkencore, si të Qendrës Ndërkombëtare të Shkencave Detare në Shqipëri (CISM), ruajtjen e menaxhimin e zonave të lagëta (WetSys "A", "B"), rritjen e kapaciteteve në infrastrukturë për studime të trashëgimisë kulturore (TWAS) etj.

Një investim i konsiderueshëm në fushën e kërkimit me projekte të EU është bërë nga Seksionet gjatë vitit 2009. Sipas thirrjeve në kuadrin e Programit FP7 janë hartuar dhe kanë kaluar fazën e parë të vlerësimit disa projekte me vlerë, si nga ana shkencore, ashtu dhe për krijimin e rrjeteve të

bashkëpunimit me vendet e Ballkanit Perëndimor në fusha të tilla si rritja e nivelit të kërkimit bazë PhD dhe Master në Shqipëri; ndërtimi i rrjeteve të qëndrueshme ndërmjet kërkuesve inovativë të WBC–EU ICT; menaxhimi i qëndrueshëm e shumëfunksional i sistemeve Agro-Silvo-Pastorale me fokus rigjenerimin e ekosistemeve natyrore; ruajtja e specieve autoktone dhe përdorimi i produkteve ushqimore tradicionale; ngritja e një rrjeti të institucioneve shkencore të vendeve të Europës JugLindore me synim përfshirjen e vlerave natyrore kulturore si një pjesë integrale e programimit të proceseve të planifikimit dhe zhvillimit të qendrave urbane dhe hapësirave rrethuese të tyre etj. Në proces vlerësimi është projekti për ngritjen e rrjeteve rajonale për monitorimin e mjedisit në të gjithë zonën gjeografike. Objektivat orientohen drejt nevojave të politikbërjes, vendimmarrjes dhe ndërgjegjësimit të publikut.

Forcimi i ndërveprimit ndërmjet shkencës dhe biznesit për kontributet e saj drejtpërdrejt në zhvillim është konsideruar si një tjetër hap i rëndësishëm i AShSh, në zbatimin e produktit shkencor, teknologjik e inovativ në zhvillimin e biznesit në Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) e më gjerë. Ky fakt është pasur parasysh në propozimin e partneritetit në kuadër të projekteve të aplikuara deri tani, p.sh. në projektin për mbështetjen e NVM-ve shqiptare (koordinator METE), për të qenë më konkurrues në tregun europian; projekti për nxitjen e kultivimit të specieve frutore autoktone të rralla nga fermerët, si një zbatim i eko-teknologjive për shfrytëzimin e specieve frutore me vlera ushqyese dhe mjedisore etj.

Rezultatet e punës shkencore të akademikëve brenda dhe jashtë vendit janë paraqitur në botime shkencore, si dhe në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Një vend të veçantë zë bashkëpunimi me shkollat e larta, meqenëse të gjithë akademikët kanë dhënë kontribut të konsiderueshëm në mësimdhënie, në udhëheqje doktoratash, në hartimin e teksteve mësimore, të kurrikulave etj.

Më poshtë po paraqesim sipas rubrikave të veçanta veprimtarinë kërkimore shkencore dhe botuese të Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike dhe Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike.

1. PROJEKTET

A. Projekte të mbështetura nga Programi Kombëtar për Kërkim dhe Zhvillim (PKKZh–MASH) dhe programe të tjera qeveritare.

Duhet theksuar fakti se programet e kërkimit të financuara nga qeveria, kanë qenë të pezulluara për shkak të reformës në kërkimin shkencor. Në këtë kontekst numri i projekteve të kërkimit ka qenë mjaft i vogël, përgjithësisht është punuar për projekte të cilat kanë qenë në përfundim të fazës 2006-2009, financimi i të cilave nuk është ekzekutuar ende. Sipas Seksioneve, projektet e zhvilluara gjatë vitit 2009 renditen si më poshtë:

I - SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE DHE ALBANOLOGJIKE

Gjatë vitit 2009 janë zhvilluar projektet për studime në fushë të sociolinguistikës, komunikimit dhe trashëgimisë kulturore, si studimet:

- *Studimi sociolinguistik për të folme të Shqipërisë së Mesme*, me drejtues Akad. Asoc. Prof. Dr. Ethem Likaj. (Departamenti i Gjuhës Shqipe të FHF, UT).

- *Komunikimi politik në Shqipëri në ditët e sotme*, Departamenti i Gazetarisë, Fakulteti i Histori – Filologjisë, UT, me bashkëdrejtues Akad. Prof. Dr. Artan Fuga.

- *Trashëgimia jonë kulturore-10 (Libri i mësuësit)*, me autorë Akad. Prof. Dr. Vasil Tole, Prof. Dr. P. Qirjazi e Dr. Lorenc Bejkon në bashkëpunim me Institutin e Kurrikulës dhe Trajnimit (IKT), Ministria e Arsimit dhe Shkencës-MASH.

Gjithashtu është përgatitur dhe miratuar nga MASH, projekti i studimit *Trashëgimia europiane-II*, nga Akad. Prof.Dr. Vasil Tole në bashkëpunim me Institutin e Kurrikulës dhe Trajnimit (IKT), Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës-MASH

II - SEKSIONI I SHKENCAVE NATYRORE DHE TEKNIKE

1. **Rregullimi i regjimit uJOR të Liqenit të Shkodrës dhe të lumit Buna: Realizimi i Batimetrisë në anën shqiptare të Liqenit të Shkodrës.** Program Kombëtar për Kërkim e Zhvillim “Uji dhe Energjia” (2007-2009) i koordinuar nga Akademik Prof. Farudin Hoxha, (AShSh) në bashkëpunim me Institutin e Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (UPT). Projekti zhvillohet në bashkëpunim edhe me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi, e cila bashkëpunon me Institutin e të saj të hidrometeorologjisë

Projekti synon kryerjen e studimeve multidisiplinore në fushën e hidrologjisë, hidraulikës, gjeomorfologjisë e batimetrisë për rregullimin e sistemit uJOR të lumit Drin-liqeni i Shkodrës-lumi Buna, për mbajtjen nën kontroll të këtij sistemi, projekt ky i cili ka filluar që prej vitit 2003.

Objektivat kryesorë konsistojnë në kryerjen e studimeve

Në fazën e dytë (2007-2009) Qeveria e personalisht Kryeministri Berisha i dhanë prioritet Rehabilitimit të Sistemit UJOR, duke financuar (nëpërmjet MASH-PKKZh_Programi “Uji dhe Energjia”) kryerjen e studimit të batimetrisë së Liqenit të Shkodrës, që u krye për herë të parë për të gjithë Liqenin (për pjesën shqiptare) nga Instituti i Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (INEUM) në bashkëpunim me një kompani shqiptare të specializuar në këtë fushë. Përfundoi **Raporti Teknik i Studimit, Atlasi i Hartave Batimetrike të Liqenit të Shkodrës**, si dhe **Albumi i Profileve Batimetrike të Liqenit të Shkodrës**.

Kryerja e këtyre studimeve bëri të mundur zbatimin e fazës së tretë të studimit madhor të Rregullimit të Sistemit UJOR: studimet hidrologjike të të gjithë sistemit uJOR, që do të fillojnë të zbatohen në vitin 2010.

Bazuar në rezultatet e studimeve do të jepen përfundimet dhe rekomandimet mbi të cilat do të realizohen nismat e planifikuara nga Qeveria në lidhje me Liqenin e Shkodrës dhe Lumin e Bunës, të rehabilitimit të ekosistemit në të gjitha parametrat, kthimit të tij në një nyje lundrimi të rëndësishme për lidhjen e dy vendeve në rrugë ujore, që do të bëjë realitet edhe këtë nismë të Qeverisë Shqiptare me atë të Malit të Zi.

2. **Platformë për shfrytëzimin integral dhe kaskadë të energjisë gjeotermale të entalpisë së ulët në kuadrin e bilancit energjetik të Shqipërisë.** Programi Kombëtar për Kërkim e Zhvillim “Uji dhe Energjia” (2007-2009) i koordinuar nga Prof. Dr. Alfred Frashëri (Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, UPT) në bashkëpunim me Prof. Dr. Andonag London (Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, UPT) dhe Akad. Prof. Dr. Salvator Bushatin (Akademia e Shkencave).

Qëllimi i studimit është hartimi i platformës për përdorimin e energjisë gjeotermale të entalpisë së ulët.

Gjatë vitit u realizuan studimet e mëposhtme: (i) Frashëri A., Çela B., Londo A., Bushati S., Pano N., Shtjefni A., Thodhorjani S, Liço R., Haxhimihali Dh., Tushe F., Kodhelaj N., Baçova R., Manehasa K., Poro A., Kumaraku A., Kurti A., 2009. *Qendra komplekse për shfrytëzimin modern kaskadë të ujërave gjeotermalë të entalpisë së ulët*; (ii) Frashëri A., Çela B., Bushati S., Londo A., Shtjefni A., Kodhelaj N., Pano N., Thodhorjani S., 2009. *Burimet e energjisë gjeotermale në Shqipëri dhe platformë për përdorimin e tyre* (Pjesa I). (iii) Frashëri A., Çela B., Bushati S., Londo A., Shtjefni A., Kodhelaj N., Pano N., Thodhorjani S., 2009. *Platformë për energjinë gjeotermale në Shqipëri*, (Pjesa 2), Skenarët e shfrytëzimit të energjisë gjeotermale në të gjithë burimet dhe pusët e ujërave termominerale në Shqipëri.

3. Vlerësimi i biodiversitetit në nivel molekular, karakterizimi i përgjigjes ndaj streseve mjedisore dhe i gjendjes fitosanitare, si dhe ruajtja e disa specieve frutore spontane, në kuadër të Programit Kombëtar për Kërkim e Zhvillim “Biodiversiteti dhe Mjedisi”, me koordinatör Akad. Asoc. Prof. Dr. E. Kongjika (ASh) në bashkëpunim me Prof. Dr. Fatbardha Babani dhe Prof. As. Arjola Bacu (Departamenti i Bioteknologjisë), Prof. Dr. Liri Dinga (Kopshti Botanik), të FSHN, UT dhe Specialistin Bajram Shera (ekonomi private), Qenam, Kamëz (2007 – 2009).

Projekti synon vlerësimin e burimeve natyrore sipas një metodologjie tip me anë të aktivizimit të grupeve të ndryshme kërkimore, duke përdorur metoda të avancuara bashkëkohore, si: studimi i polimorfizmit gjenetik dhe i lidhjeve filogjenike ndërmjet popullatave shqiptare të disa specieve të rrezikuara për zhdukje me anë të markerëve molekularë (SSR dhe RAPD); vlerësimi i gjenotipeve me anë të metodës së imazhit të fluoreshencës për tipare të qëndrueshmërisë ndaj streseve; realizimi me anë të metodës serologjike ELISA i kontrollit fitosanitar për verifikimin e kontaminimit nga sëmundje virusale. Projekti ka objektiv final krijimin e infrastrukturave për ruajtjen e gjermoplazmës së specieve frutore me përdorim të pakët. Realizimi i këtij projekti është bërë i mundur nga bashkëpunimi i frytshëm reciprok i grupeve kërkimore me specialistë nga fusha e biznesit.

Gjatë vitit 2009, është ngritur repozitori “pro temporaria” në Kopshtin Botanik me përfaqësues të popullatave të ndryshme, të vlerësuara me metoda shkencore, një koleksion farash dhe koleksioni “in vitro” në Departamentin e Bioteknologjisë të FSHN të UT. Rezultatet shkencore të studimit janë paraqitur në 3 artikuj shkencorë, në 2 konferenca shkencore prej të cilave një ndërkombëtare, 3 udhëheqje doktorature dhe një master.

4. Monitorimi i habitateve me rëndësi Europiane në rajonin grykëderdhje e lumit Vjosë - grykëderdhje e lumit Bunë, në kuadrin e Programit të Monitorimit Kombëtar të sipërfaqeve të mbrojtura dhe të habitateve me rëndësi Europiane (Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave), me koordinatör Prof. Dr. Alfred Mullaj (FSHN, UT) në bashkëpunim me Akad. Prof. Dr. Jani Vangjeli, Prof. Dr. Lefter Kashta, Dr. Skerdilajd Xhulaj dhe Msc. Dhimitër Peçi (FSHN, UT)

Projekti ka për objekt studimi dhe monitorimi: (i) pasurinë floristike, llojet e rralla dhe të rrezikuara dhe propozimet për ndryshime në statusin e rrezikimit; (ii) tipet kryesore të habitateve; gjendja aktuale dhe tendencat; klasifikimi sipas CORINE BIOTOPE dhe Direktivës së Habitave të Komunitetit Europian apo “Natura 2000”; Kartografimi apo harta e habitateve natyrore; (iii) rreziqet kryesore dhe vlerësimin e tyre: Masat për ruajtjen, mbrojtjen, mirëadministrimin dhe përmirësimin e situatës në këtë rajon; (iv) hartimin e një programi për monitorimin e biodiversitetit dhe vlerësimin e gjendjes në këto zona mbështetur në të dhënat sasiore; (v) përcaktimin dhe vlerësimin e habitateve dhe llojeve me interes europian (të shtojcave të direktivës së Habitatit-Direktiva 43/92 dhe të shpendëve-Direktiva 79/409), që gjenden në këtë rajon dhe përgatitja e informacionit sipas formatit bashkëngjitur për Komisionin Europian lidhur me mundësinë e shpalljes së një pjese të këtij rajoni, zonë me interes ruajtjeje për t’iu bashkëngjitur Rrjetit Ekologjik NATURA 2000.

5. Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Butrintit, në kuadër të menaxhimit të integruar të Zonës Bregdetare, (Asistencë e Bankës Botërore për Qeverinë Shqiptare) me koordinatör Akad. Prof. Dr. Jani Vangjeli.

Projekti ka për synim përgatitjen e planit të menaxhimit të integruar të zonës bregdetare me qëllim mbrojtjen e vlerave dhe produktivitetit të burimeve natyrore detare dhe bregdetare dhe për të stimuluar zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm. Sipas këtij objektiivi parashikohet edhe mbështetja

për politikat e zhvillimit, kuadrin rregullator për menaxhimin e qëndrueshëm të bregdetit dhe investime rajonale për përmirësim të planit të zhvillimit dhe përdorimit të tokës, përmirësimin e kushteve të mjedisit dhe infrastukturës rajonale për tërheqjen e investimeve private drejt një turizmi të qëndrueshëm.

Lidhur me gjendjen aktuale të Parkut të Butrintit dhe për përmirësimin e kësaj gjendjeje, projekti paraqet disa propozime: (i) të ruhet diversiteti biologjik në gjendje sa të jetë e mundur të pashqetësuar; (ii) të mbrohen resurset natyrore bazë nga përdorimet për qëllime të tjera që mund të jenë dëmtoese për diversitetin biologjik të zonës; (iii) përcaktimi i statusit të përshtatshëm për Parkun e Butrintit; (iv) rehabilitimi i zonës së pyjeve dhe shkorretave Mesdhetare të Parkut të Butrintit, aktualisht shumë të degraduara nga shfrytëzimi i tepruar për qëllime të ndryshme; (v) monitorimi i rregullt dhe në kompleks për të njohur dinamikën e treguesve cilësorë e sasiorë; (vi) krijimi i një sistemi të komanduar në kanal in e komunikimit të Liqenit të Butrintit me detin, dhe (vii) futja e komanduar e Bistricës në Liqenin e Butrintit.

6. Metalet nanostrukturore të prodhuara nëpërmjet deformimit të fortë plastik, në kuadër të PKKZh-„Materialet” (2008 – 2010) me koordinator Akad. Asoc. Prof. Dr. A.Veveçka.

Metoda e Deformimit të Fortë Plastik (DFP) është një metodë e re e përpunimit të metaleve që mundëson krijimin e nanostrukturës, dmth të materialeve me përmasa kokrrizash të rendit nano, që quhen edhe metale nanostrukturore dhe që kanë veti fizike dhe mekanike të përmirësuara, në krahasim me metalet tradicionalë. Kjo metodë ka filluar të studiohet dhe përdoret në botë dy dekadat e fundit.

Qëllimi i projektit është njohja me teknikat e Deformimit të Fortë Plastik dhe studimi i vetive të disa metaleve, kryesisht lidhje të Al pas DFP. Gjatë vitit 2009 projekti nuk u financua për mungesë fondesh, por mendohet të jepet fondi në 2010.

7. Sjellja mekanike e lidhjeve nanokristaline të Aluminit, të përfuara nëpërmjet ECAP, në kuadër të Protokollit të Bashkëpunimit Shkencor Bilateral midis Shqipërisë dhe Italisë (2008 – 2009) me koordinator Akad. Asoc. Prof. Dr. A.Veveçka.

Qëllimi i projektit është studimi i vetive mekanike dhe mikrostrukturës së lidhjeve industriale të Al, të përpunuara me ECAP, që është një teknikë e Deformimit të Fortë Plastik. Përpunimi me ECAP prodhon materiale me përmasa nanokristaline, gjë që përmirëson në mënyrë të ndjeshme vetitë mekanike dhe fizike të tyre. Lidhjet e aluminit janë nder lidhjet më të përdorura në industri, për shkak të cilësive të tyre specifike.

Konkretisht në kuadrin e projektit gjatë vitit 2009 është punuar mbi: “Studime të Mikrostrukturës dhe mikrofortësisë të një lidhjeje alumini Al-Mg-Si të presuar nëpërmjet ECAP”.

B. Projekte në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Kërkimor-Shkencor dhe Artistik midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (2009-2010), nënshkruar nga Kryetarët e të dy Akademive brenda së cilës përfshihen projektet e mëposhtme:

I - SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE DHE ALBANOLOGJIKE

1. Botimi i Fjalorit Enciklopedik Shqiptar. (2009 2010) Projekt i përbashkët i dy Akademive, AShSh (SShShA - IGjL - QSA) dhe AShAK (SGjL);

Botimi i FESH përmbyll një punë komplekse disavejeçare, të redaksive të 21 fushave tematike dhe qindra studiuesve. FESH-i shënon një arritje të rëndësishme të shkencës e kulturës shqiptare, si një

vepër shkencore sintetike dhe përgjithësuese, që pasqyron botën shqiptare në tërësinë e saj, nga lashtësia deri në ditët tona, historinë e kombit shqiptar dhe të trevave të tij etnike.

2. Enciklopedia e artit shqiptar. (2009) Botim i përbashkët i AShSh (SShShA, QSA) dhe AShAK (SA); me koordinatör dhe redaktor përgjegjës Prof. Dr. Josif Papagjoni (AShSh) dhe Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

AShSh e ka përfunduar plotësisht punën, duke e bërë gati për botim, ndërsa varianti i dërguar nga AShAK është kthyer me vërejtjet përkatëse dhe pritët materiali i përmirësuar.

3. Kërkime arkeologjike në Kosovë: Përpilimi i Hartës arkeologjike, II. Gërmime arkeologjike në Rrafshin e Kosovës. (2009-vazhdim) Projekt i përbashkët i Muzeut të Kosovës dhe AShSh (SShShA) dhe QSA (IA) me koordinatörë përkatësisht K. Luca dhe L. Perzhita.

4. Veshjet popullore të Kosovës. Volumi V. (2009 e në vazhdim), që është vazhdim i korpusit të veshjeve popullore shqiptare të Institutit Albanologjik të Prishtinës dhe AShSh (SShShA) dhe , QSA (IAKSA), me koordinatör Prof. Dr. Afërdita Onuzin.

Është përfunduar mbledhja e materialit dhe përgatitja për botim. Gjatë ekspeditave ka kontribuar edhe Ukë Gjema.

5. Ekspeditë e përbashkët për mbledhjen e lëndës folklorike, etnologjike gjuhësore në trevat e paeksploruara sa duhet. (2009 e në vazhdim), ASHAK (IAP-i) dhe ASHSH (SSHNA, QSA);

6. Çështje të standardizimit të shqipes dhe të terminologjisë - veprimtari e Këshillit Ndërrakademik. (2009-vazhdim), Bashkëpunim i vazhdueshëm midis AShSh (IGjL - QSA) dhe AShAK (SGjL);

Në kuadër të zbatimit të Protokollit të Bashkëpunimit, gjatë 2009-ës janë përgatitur projektet për veprimtaritë që do të zhvillohen në 2010 e në vazhdim, si:

1. Tryeza shkencore Për kritikën letrare; ASHSH (SSHSHA, QSA), në bashkëpunim me ASHAK (SGjL) Tiranë (2010);

II - SEKSIONI I SHKENCAVE NATYRORE DHE TEKNIKE

1. Hartimi dhe dorëzimi për shtyp i “Fjalorit përkufizues të termave të informatikës” (Anglisht-Shqip) me 3000 fjalë. Projekt i përbashkët i AShAK (Seksioni i Gjuhësisë dhe Letërsisë) dhe AShSh (Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike; Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë – Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Fakulteti i Teknologjive të Informacionit – Universiteti Politeknik i Tiranës), me koordinatör Akad. Prof. Dr. Neki Frashëri (AShSh) dhe Prof. Nebi Caka (AShAK), 2009 – 2011.

Qëllimi i projektit është të pasqyrohet pasuria leksikore në fushën e terminologjisë së shkencës së informatikës. Ky projekt përfaqëson hartimin e Fjalorit shpjegues për terminologjinë e informatikës, si përpjekje e parë në këtë hulli. Ai do të jetë shumë i dobishëm jo vetëm për specialistët e kësaj fushe, por edhe për publikun e gjerë në teknologjitë e informacionit, për studentët, mësuesit e informatikës etj. Botimi i një Fjalori të tillë bëhet domosdoshmëri për vetë zhvillimet e mëdha që ka marrë kjo shkencë dhe degët e shumta të saj në Shqipëri vitet e fundit; Ai do të shënojë një hap të rëndësishëm drejt sistemit, standardizimit dhe shqipërimit të termave të informatikës dhe të degëve të shumta të saj, duke zëvendësuar në mjaft raste terma të huaj të përdorur në punimet ose tekstet e kësaj fushe.

Gjatë vitit 2009, janë realizuar: miratimi i redaksisë dhe i grupeve të punës për nënshkrimin e kontratës së bashkëpunimit dy-palësh, hartimi i platformës së punës (parimet, kriteret, afatet etj.). Gjatë vitit 2010 materialet ekzistuese do të shqyrtohen në redaksi dhe në grupet e punës, mbi bazën e të cilave do të punohet për hartimin e Fjalorit, si dhe do të zhvillohen takime dy-palëshe të redaksisë (në Prishtinë e në Tiranë).

2. Fjalor shpjegues i termave të botanikës është projekt i përbashkët i AShAK (Seksioni i Shkencave Natyrore) dhe AShSh (Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike; Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë – Qendra e Studimeve Albanologjike), me koordinatör Akad. Prof. Dr. Jani Vangjeli, (AShSh) dhe Akad. Prof. Dr. Feriz Krasniqi (AShAK). (2009 – 2010). Nga ana e AShSh bashkëpunon edhe Akad. Asoc. Prof. Dr. Efigjeni Kongjika, ndërsa nga pala e AShAK dhe Akad. Prof. Dr. Latif Susuri. Redaktor i fjalorit do të jetë Prof. Dr. Agron Duro.

Ky Projekt është vijim i punës madhore të sendërtuar në Fjalorin e termave të botanikës, shumëgjuhësh, të kryer po nga ky staf e në këtë aspekt synon grumbullimin e pasurisë gjuhësore në fushën e terminologjisë së botanikës. Fjalori do të jetë shumë i dobishëm për specialistët e kësaj fushe, si dhe për një rreth më të gjerë përdoruesish (biologë, inxhinierë e pyjesh, agronomë, mësues, studentë e publikun e gjerë). Fjalori do të përfaqësojë një hap të rëndësishëm drejt shqipërimin, njësimin të termave dhe pasurimit të kësaj shkence e degëve të lidhura me të. Fjalori do të përmbajë rreth 11 000 zëra të shpjeguar, shoqëruar me përkthimin në gjuhën angleze e latine dhe me ilustrimet përkatëse. Gjatë 2009, në një takim dypalësh në Prishtinë rezultoi se arritjet ishin mjaft pozitive; Akad. J. Vangjeli realizoi më se 9 000 zëra; pjesa tjetër, prej rreth 2 000 zëra, është shpjeguar nga anëtarët e tjerë të redaksisë së Fjalorit. Përfundimi i fjalorit dhe dorëzimi i tij për në shtyp pritet të realizohen brenda 6-mujorit të parë të vitit 2010.

3. Studim pilot për menaxhimin e ekosistemeve natyrore me Status Specifik të Mbrojtur të dy zonave me rëndësi në Shqipëri dhe Kosovë. Projekt i përbashkët i AShAK (Seksioni i Shkencave Natyrore) dhe AShSh (Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike; Muzeu i Shkencave të Natyrës, Kopshti Botanik, FShN, UT; FShP, UBT), me koordinatör Akad. Prof. Dr. Jani Vangjeli, (AShSh) dhe Akad. Prof. Dr. Feriz Krasniqi (AShAK). (2009-2012).

Projekti parashikon hartimin e një udhëzuesi metodologjik për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, nga një shoqëri e ndërgrjegjësuar dhe e miqësuar me natyrën, që do t'u sugjerohet organeve përkatëse të dy vendeve. Nëpërmjet një instrumenti matematikor do të demonstron se si një model analizimi i ndihmon vendimmarrësit dhe popullsinë lokale në zhvillimin e qëndrueshëm të një rajoni, në kuadër të zhvillimit ekonomik dhe të mbrojtjes së biodiversitetit. Projekti do të realizohet në një zonë pilot dhe do të shërbejë si model demonstrimi në kuadër të transferimit të teknologjive, metodologjive dhe unifikimit të eksperiencave më të mira të të dy vendeve.

Gjatë vitit 2009 është hartuar e diskutuar projekt ideja me partnerët. Pas konsultimeve të realizuara gjatë një takimi në Prishtinë, në përshtatje edhe me standardet ndërkombëtare titulli i projektit u përmirësua në: ***Ndërtimi i një sistemi ekspert për evidentimin e vlerave specifike, natyrore dhe të trashëgimisë kulturore të Alpeve Ballkanike në interes të zhvillimit të qëndrueshëm turistik dhe ekonomik.*** Koordinatorët përkatës morën përsipër të krijojnë grupet e punës dhe të hartojnë metodologjinë e detajuar të studimit.

4. Inventarizimi i virozave dhe shëndetësimi i materialit mbjellës të specieve frutore dhe vreshtave në Kosovë dhe Shqipëri (2009 – në vazhdim). Është projekt i përbashkët i AShAK (Seksioni i Shkencave Natyrore) dhe AShSh (Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike; Departamenti i Bioteknologjisë, FShN, UT, Departamenti i Hortikulturës dhe Mbrojtjes së Bimëve, FBM, UBT; Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë, MBUMK; Instituti Agronomik Mesdhetar CIHEAM, Valenzano, Bari, Itali), me koordinatör Akad. e Asoc. Prof. Dr. Efigjeni Kongjika (AShSh) dhe Akad. Prof. Dr. Latif Susuri.

Projekti synon hartimin e një manuali metodik për detektimin, shëndetësimin e gjendjes virale të materialit mbjellës bimor. Projekti do të ndihmojë në përmirësimin e ekspertizës së kërkuesve të

rinj, duke përdorur metodat serologjike e molekulare të detektimit të hershëm në kushtet e një tregu të pakontrolluar të prodhimit të fidanëve të pemëve frutore dhe shkëmbimit të tyre në rajon.

Është përgatitur projekti paraparak nga specialistë të fushës përkatëse të të dy vendeve dhe po punohet për hartimin e metodikave përkatëse.

5. Sterilizimi i materialeve mjekësore dhe reduktimi i ngarkesës mikrobike në ushqime, si një mundësi e re për sigurinë ushqimore, me anën e rrezatimit jonizues. (2009 – në vazhdim). Është projekt i përbashkët i AShSh (Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike; Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar - FShN, UT; Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë - MBUMK; Instituti i Shëndetit Publik – MSh) dhe AShAK (Seksioni i Shkencave Natyrore; Departamenti i Fizikës, FShNM, UP), me koordinator Prof. Dr. Andon Dodbiba, dhe Dr. Sadik Bekteshi.

Projekti synon futjen e metodave të reja të sterilizimit të materialeve mjekësore dhe të uljes së ngarkesës mikrobike në ushqime me anën e rrezatimit jonizues, në fusha të rëndësishme si mjekësia dhe siguria ushqimore, në përputhje me standardet europiane. Ai krijon mundësi për mbrojtje mikrotezash apo disertacionesh në të dy vendet, duke siguruar krijimin e burimeve njerëzore të specializuara nga kërkues të rinj. Gjatë vitit 2009 janë realizuar kontakte midis dy grupeve për hartimin e draft-projektit, si dhe janë hartuar metodikat e përbashkëta për rrezitjen, matjen e sterilitetit në materialet mjekësore dhe të ngarkesës mikrobike në mostrat ushqimore.

Gjatë vitit 2009, janë përcaktuar tematikat e referateve, kumtesave dhe posterave si dhe janë vendosur kontaktet me kontribuesit vendës e të huaj, që do të marrin pjesë me punimet e tyre në këtë konferencë.

Duhet theksuar se në kuadrin e zbatimit të Protokollit të Bashkëpunimit me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, për vitin 2009 ka pasur nga Qeveria një fond të kufizuar prej 1 000 000 lekësh, të cilat i janë dhënë projektit të *Ndërtimit të Hartës Arkeologjike të Kosovës*. Buxheti tjetër është shpenzuar për veprimtaritë e ndryshme si konferenca shkencore, takime të koordinatorëve të disa projekteve në Prishtinë etj. Gjatë vitit 2009, për një pjesë të projekteve, është realizuar vetëm përgatitja e projekteve, duke shfrytëzuar lidhjet elektronike në komunikimin me palën kosovare. Pritet buxheti i vitit 2010 nga Qeveria, që të plotësohet dhe pjesa e financimit për çdo projekt. Paraprakisht është rishikuar dhe është diskutuar nga të dy palët *Rregullorja e Zbatimit të Protokollit të Bashkëpunimit midis të dy Akademive*, ku përcaktohen fushat prioritare të bashkëpunimit, llojet e projekteve, pjesëmarrësit potencialë, mënyra e përgatitjes së kontratave, veprimtaritë që do të financohen nga të dy palët etj.

C. Projekte të mbështetura nga Akademi të Shkencave dhe organizma evropiane apo ndërkombëtare

- SEKSIONI I SHKENCAVE NATYRORE DHE TEKNIKE

1. Fuqizimi dhe forcimi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë – rritja e kapacitetit konsultues të saj, “EASA-SAC” (Empowering of Academy of Sciences of Albania-Strengthening - they Advisory Capacity) (2009-2010). Projekti u përzgjodh nga konkurrimi në vitin 2008 dhe u financua nga IAP në kuadër të Programit “Për rritjen e kapaciteteve të Akademive të Shkencave të vendeve në zhvillim”. Projekti drejtohet nga Akad. Prof. Dr. Salvator Bushati në bashkëpunim me Seksionet shkencore, Bibliotekën shkencore, Njësinë e Projekteve dhe strukturat e tjera mbështetëse të AShSh. Në zhvillimin e Projektit japin kontributin e tyre edhe specialistë nga Akademia e Shkencave e Turqisë (TUBA), Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Maqedonisë dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve e Malit të Zi.

Objektivat e Projektit ishin hartimi i dokumenteve bazë të AShSh (Statutit, Rregullores së brendshme të Akademisë, Seksioneve dhe njësive të tjera), si edhe forcimi i kapaciteteve të AShSh për të qenë një organizëm konsulent dhe ekspert i shtetit dhe shoqërisë sipas edhe prioriteteve të reja të IAP. Bashkëpunimet me Akademitë e IAP-it, në statusin e ri të AShSh, do të synojnë përmirësimin më tej të imazhit të shkencës dhe stimulimin e brezit të ri për karrierë në shkencë; fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet shkencave natyrore dhe shoqërore dhe disiplinave të tjera veçanërisht në fushën e shëndetit, energjisë, teknologjive të informacionit, bioteknologjisë dhe biodiversitetit, biosigurisë, zvogëlimit të varfërisë etj.; fuqizimin e bashkëpunimit me të tjera organizma shkencorë e ndërkombëtarë. Projekti i kushton vëmendje të veçantë krijimit të infrastrukturës së përshtatshme në AShSh për të përballuar veprimtaritë në përputhje me funksionet e saj.

Gjatë vitit 2009, në kuadër të këtij projekti dhe me mbështetjen edhe të kontributit të donatorëve privatë, në AShSh u bënë transformime të mjediseve, të cilat sollën një progres të dukshëm në zhvillimin e veprimtarive të larmishme; kështu u rikonstruktua krejtësisht Salla e Madhe e mbledhjeve e emërtuar “Salla Aleks Buda” dhe u pajis me mjete audiovizive moderne; gjithashtu për një paraqitje më dinjitoze të AShSh u rehabilituan një pjesë e mjediseve të Kryesisë, mjediset sociale etj. Për realizimin e objektivave të Projektit, gjatë vitit 2010, planifikohen veprimtari edhe me akademitë bashkëpunëtoare.

2. Nxitja e kultivimit të specieve frutore autoktone të rralla, (ICRAFT) (Incentives for the cultivation of rare autochthonous fruit trees) është paraqitur nga Shoqata Shqiptare e Specialistëve të Pyjeve, sponsorizuar nga Programi GEF/SGP: ALB/SGP/OP4/Y3/CORE/2009/02 (Global Environment Facility/Small Grants Programme, i zhvilluar nga PNUD). Projekti realizohet nga Biznesi dhe AShSh me bashkëdrejtues specialistin Bajram Shera dhe Akad. Asoc. Prof. Dr. Efigjeni Kongjika (2009 – 2010).

Projekti fokusohet në fushën e ruajtjes së vlerave të biodiversitetit për pasurimin e gjermoplazmës së specieve autoktone duke shfrytëzuar forma origjinale me nivel të lartë prodhimi dhe me vlera dietetike-terapeutike ose me mundësi daljeje në treg jashtë periudhës së pikut të zakonshëm. Ngritja e fidanishteve dhe e fermave të reja mund të konsiderohet si përshtatje e eko-teknologjive për shfrytëzimin e specieve frutore me vlera ushqyese dhe mjedisore përmes kultivimit nga fermerët shqiptarë. Projekti do të shërbejë si model për nxitjen e zhvillimit të pemëtarisë biologjike, ashtu dhe për pasurimin e kapaciteteve eko-turistike të zonave kodrinore të vendit, duke shfrytëzuar risitë shkencore të agrobiologjisë në ndihmë të NVM-ve shqiptare. Që në hapat e parë të zhvillimit të Projektit, është vërejtur interesimi i subjekteve private për përdorimin e specieve frutore me vlera të veçanta në pasurimin e fermave të zonave të Shqipërisë së mesme.

D. Projekte ndërkombëtare në Kuadër të Programeve të BE (FP6 dhe FP7 etj.) dhe organizatave të tjera

I - SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE DHE ALBANOLOGJIKE

1. Sfera publike europiane, projekt i Bashkimit Europian. Me studiues nga një numër vendesh, pjesëmarrës në projekt Akad. A. Fuga për studimin e mediave në Francë.

2. Kufijtë ne qytete dhe qytetet ne kufi. Projekt i Egide (Ministria e Jashtme e Francës) me bashkëdrejtues Akad. Artan Fuga.

3. Probleme te luftës kundër diskriminimit racial. Projekt i rajonit Ile de France me bashkëdrejtues Akad. Artan Fuga.

4. Mediat në komunikimin ndërkulturor. Projekt i UNESCO, pjesëmarrës në projekt Akad. A. Fuga (Departamenti i Shkencave të Komunikimit dhe Informimit të Universitetit të Strasburgut).

5. Katalogimi i trashëgimisë kulturore shpirtërore. Projekt i UNESCO/Japan Funds-in-Trust for the Preservation and Promotion of the Intangible Cultural Heritage.

II - SEKSIONI I SHKENCAVE NATYRORE DHE TEKNIKE

1. Teknologjia e komunikimit, e inovacionit dhe zhvillimi teknologjik i kërkimit (Communication and Innovation Technology and Technological Development of the Research), në kuadër të Programit FP7 të BE, drejtohet nga Akad. Prof. Dr. Neki Frashëri (AShSh) (2009-).

Qëllimi i Projektit është vlerësimi sistematik i rrjeteve efektive të bashkëpunimit dhe të transferimit të metodologjive e të teknologjive dhe zhvillimit të inovacioneve në nivel lokal e rajonal, në saje të të cilave do të realizohet forcimi i rrjeteve të bashkëpunimit dhe krijimi i rrjeteve të reja për informim, zhvillim dhe transferim teknologjish dhe metodologjish, si dhe integrimi i kërkuesve shqiptarë në programet e kërkimit evropian e ndërkombëtar. Punët tashmë të nisura që lidhen me vlerësimin sistematik të rrjeteve efektive të bashkëpunimit dhe transferimin e teknologjive e të metodologjive dhe të zhvillimit të inovacioneve në nivel lokal e rajonal me objektivat: (i) Integrimin e Teknologjive të Informacionit dhe Zhvillimin Teknologjik të Kërkimit në sistemet e inovacionit dhe të iniciativave shoqërore të informacionit; (ii) forcimin e konkurrencës në nivel lokal dhe rajonal nëpërmjet Teknologjive të Informacionit e Komunikimit, inovacionit dhe aktiviteteve të zhvillimit; (iii) ndikimin në krijimin dhe lidhjen e rrjeteve nëpërmjet efektit të instrumenteve evropiane dhe kuadrit të politikave institucionale; (iv). ndikimin në rrjetet e inovacionit në nisjen e zhvillimit të informacionit dhe teknologjisë nëpërmjet nxitjes institucionale; (v) mundësi më të mira për sinergji dhe lidhje më të mëdha ndërmjet zhvillimit të teknologjisë së kërkimit dhe zhvillimit të informacionit shkencor dhe (vi) ndikimin e sistemeve të inovacionit në bashkëpunimin e kërkimit etj.

Gjatë vitin 2009 janë realizuar: (i) fillimi i integritit të Teknologjisë së Informacionit dhe Zhvillimi Teknologjik i Kërkimit në sistemet e inovacionit dhe të iniciativave shoqërore të informacionit; (ii) hartimi i projekt-idesë, programit për TIK-KZHT, përcaktimi i aktorëve dhe është ngritur dhe grupi *ad hoc*; (iii) u mbajt një konference për prezantimin e vizionit, të qëllimit, objektivave dhe të planit të veprimit (N.Frashëri); (iv) është publikuar rrjeti dhe programi.

2. Program trajnimi për zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve ndërkombëtare të kërkimit për shkencëtarët e rinj të Shqipërisë. (Training Programme on International Research Project Development and Management for young Scientists of Albania- TRAINASA). Projekti është zhvilluar në Programin Kuadër të Bashkimit Europian FP6 dhe i koordinuar nga AShSh në bashkëpunim me Qendrën Geonardo, Hungari). Drejtues projekti për palën shqiptare - AShSh (Prof. Dr. Vladimir Nika), (2008 – 2009).

Qëllimi i projektit është forcimi i potencialit të kërkimit për shkencëtarët shqiptarë për të mbajtur aktive pjesëmarrjen në projekte ndërkombëtare të kërkimit, zhvillimin dhe menaxhimin në fushën e shkencave natyrore. Synimi rrjedh nga objektivi strategjik i stabilizimit dhe forcimit të potencialit të kërkimit në Vendet e Ballkanit Perëndimor.

Projekti synoi në trajnimin e shkencëtarëve të rinj të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe të institucioneve të tjera kërkimore të vendit, lidhur me administrimin dhe zhvillimin e projekteve të kërkimit shkencor ndërkombëtar; në veçanti, trajnimi lidhur me sigurimin e mundësive të shkencëtarëve të rinj për të gjetur partnerë ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor për zbatimin e ideve të tyre në projekte të përbashkëta.

Gjatë vitit 2009, u organizua një seminar lidhur me përvojën e deritanishme dhe rrjetin e bashkëpunimit ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor (WBC-network) në Programet Kuadër të Bashkimit Evropian. Ky ishte një seminar përmbyllës lidhur me përfundimin me sukses të tre seminareve të trajnimit të zhvilluara në Shqipëri gjatë vitit 2008, në të cilat morën pjesë rreth 70 shkencëtare të rinj nga institucione kërkimore të vendit. Në seminarin përmbyllës në Tiranë morën pjesë më shumë se 50 pjesëmarrës nga vendi dhe nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Në veçanti, u diskutua për pjesëmarrjen në projektet e FP7, si dhe u paraqit përvoja e vendeve të Ballkanit Perëndimor (WBC) lidhur me këtë pjesëmarrje. U diskutua, gjithashtu, për të siguruar mundësinë që shkencëtarët e rinj të gjejnë partnerë për idetë e tyre në projekte. Një seminar përmbyllës për këtë projekt u zhvillua në Hungari (mars 2009) me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve nga Shqipëria.

3. Projekti i asistencës teknike për realizimin dhe menaxhimin e një Qendre Ndërkombëtare të Shkencave Detare në Shqipëri. (Progetto di assistenza tecnica alla realizzazione ed alla gestione di un Centro Internazionale di Scienze del Mare in Albania- CISM), (2006-2009). Program i iniciativës komunitare PIC – INTERREG III – Italia-Albania, Misura 2.1: Tutela e Valorizzazione Ambientale, me bashkëpunimin e Rajonit të Pulias, Projektit të Agjencisë Rajonale të Mbrojtjes së Mjedisit të Pulias (ARPA Puglia), Konsorciumit Ndëruniversitar Italian për Shkencat Detare (CoNISMa), Institutit të Kërkimeve për Mbrojtjen Hidrogeologjike (IRPI-CNR); Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (me koordinatör Dr. Zamir Dedej), Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (me koordinatör Akad.Prof.Dr. Salvator Bushati) dhe Fakultetit të Shkencave Natyrore të Universitetit të Tiranës (me koordinatör Dr. Sajmir Beqiraj).

Projekti ka përfunduar me 2008, por gjatë vitit 2009 u përgatit dhe u botua raporti përfundimtar në 3 vëllime, i cili shoqërohet me një numër të konsiderueshëm hartash tematike. Studimi konsistoi në realizimin e dy objektivave kryesore: (i) në projektimin e Qendrës; dhe (ii) në zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta për riparimin, mbrojtjen dhe administrimin e ekosistemeve detare dhe të hapësirës bregdetare.

Nga ana e autorëve shqiptare u përgatitën shumë studime për fushat e ndryshme si në biologjinë detare (Plankton, Nekton, Benkton), gjeologjinë detare, erozionin bregdetar e modelime të ndryshme me të, kimizmin dhe fizikën e ujërave detare e studime hidrologjike etj., të cilat më pas u përqendruan në dy ekspedita disa ditorëshe në Gjirin e Vlorës.

Studimi u përfshi në një botim prej tre volumesh dhe me një numër hartash tematike. Gjithashtu u publikuan në JCR disa studime të përbashkëta institucionale e multidisiplinore, me përfshirje të kërkuesve të rinj.

Risi e këtij projekti ishte edhe përgatitja dhe mbrojtja e disa Diplomave nga studentë të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minerave me tematikën e Projektit.

Pritet mbështetja nga ana e Qeverisë për dhënien e mjediseve ku do të zbatohet projekti i ngritjes së kësaj Qendre.

4. Vlerësimi i rrezikut të dëmtimeve emergjente të monumenteve arkeologjike sipas përdorimit të metodave të reja gjeofizike (Emergency damage risk assessment of Archaeological monuments in Albania by new geophysical methods) - EDRAAMG në kuadër të Programit të Rrjetit të Akademive të Vendeve të Botës së Tretë për kërkuesit e rinj, (TWAS), me koordinatör kërkuesin e ri, Dr. Hamza Reçin.

Qëllimi është përdorimi i metodologjive dhe instrumenteve arkeometrike për studimin e objekteve historike me objektivat: (i) rinovimin e instrumenteve shkencore gjeofizike që do të përdoren në fushën e arkeologjisë e historisë (Durrës, Apolloni, Butrint etj.); (ii) krijimin e njohurive të përshtatshme për të kryer vëzhgime gjeofizike; (iii) vlerësimin dhe karakterizimin e monumenteve historike, strukturave të gjetura dhe të përzgjedhura; (iv) interpretimin e të dhënave

gjeofizike të marra nga mostrat dhe përcaktimin e karakteristikave të tyre; (v) përhapjen e rezultateve përmes organizimit të workshopeve

Projekti u vlerësua pozitivisht nga komisioni përzgjedhës dhe pritet sigurimi i instrumentit me të cilin do të fillohen studimet eksperimentale në terren. Për sigurimin e instrumenteve, një kontribut dha edhe Fondacioni i Trashëgimisë Kulturore Shqiptare.

5. Koordinimi i politikave të kërkimit me vendet e Ballkanit Perëndimor (Coordination of Research Policies with the Western Balkan Countries) - WBC-INCO.NET (Western Balkan Countries Inco-Net Support in the field of ICT), në kuadër të Programit BE-FP7 me koordinator të projektit Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës e bashkëpunëtorë CIVETI, AShSh (Akad. Prof. Dr. Neki Frashëri) dhe UPT (2009-2010)

Qëllimi është të sigurojë të kuptuarin gjithëpërfshirës për kuadrin korrent të politikave BE-WBC ICT RTD dhe bashkëpunimit të kërkimit e zhvillimit teknologjik, të optimizojë kuadrin e politikave dhe bashkëpunimin në kërkim, duke iu adresuar aktorëve përkatës, të mbështesë ndërtimin e rrjeteve të qëndrueshme ndërmjet kërkuesve inovativë të WBC-EU ICT për bashkëpunim në prioritetin e FP7-ICT, të forcojë kapacitetet dhe aftësitë e kërkuesve të WBC për të marrë pjesë dhe konkurruar në FP 7 si koordinatorë.

Gjatë vitit 2009, AShSh ka qenë aktive në takimet e zhvilluara, përmbushjen e detyrave, në plotësimin e intervistave me shoqërinë, si dhe në referimet në konferencat e zhvilluara në Shkup (FYROM), Malibor (Slloveni) etj.

Gjithashtu, është bërë një punë e madhe në lidhje me aplikimet për projekte në kuadër të programeve e organizmave ndërkombëtarë, për disa prej të cilave kemi marrë edhe konfirmimet për pranimin e shprehjes së interesit të projekteve, si vijon:

1. Zhvillimi i praktikave të mirëmenaxhimit për reduktimin e ngarkesës ushqyese dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në Gjirin e Lalzit. (Development of good management practices for nutrient load reduction and sustainable use of natural resources in Lalzi's Gulf-DGMPNLSUNR), përgatitur për konkurrim në Programin Global Environment & Technology Foundation (GETF) në bashkëpunim me Regional Environmental Centre for Central and Eastern Europe (REC) në kuadër të Programit "Living Water Exchange" të GEF/UNDP. Përgatitja e projektit u realizua nga Prof. Dr. Arsen Proko (Njësia e projekteve, AShSh) me partnerë nga UT, Komuna Sukth, Shoqata e Peshkatarëve, MMPAU, GEF/SGP (2009 – 2011).

Objektivat e Projektit janë zbatimi i metodologjive të reja në menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore, në zbutjen e impaktit mjedisor, veçanërisht në reduktimin e ngarkesës ushqyese dhe në një sistem novator monitorimi. Projekti do të përqendrohet në rehabilitimin e ekosistemit lagunor të Bishtarakës në Gjirin e Lalzit.

2. Ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e kërkimit në Shqipëri (Capacity Building in Research Management in Albania) përgatitur në kuadër të Programit SCOPES, Fondit Zvicëran për Shkencën (SNF) (2010-2011), me koordinator Akademinë e Shkencave të Zvicrës e partnerë: AShSh, UT dhe Institutin për Demokracinë dhe Median.

Qëllimi kryesor i projektit është të kontribuojë në një nivel më të lartë cilësor të kërkimit bazë Master dhe Doktoraturë në Shqipëri dhe për rrjedhojë tek një vëllim më i lartë tregu të kërkuesve të ardhshëm dhe vendimmarrësve, me objektivat kryesorë: (i) të asistojë në rritjen e kapaciteteve të AShSh që ajo të jetë pjesë e rëndësishme në sistemin kombëtar të edukimit dhe shkencës si një koordinatorë efektive në aktivitetet e reja të orientuara për ndërtimin e kapaciteteve në menaxhimin e kërkimit të universiteteve; (ii) të ndërtojë kapacitetet e IDM si një shërbim sigures i aktiviteteve

të ndërtimit të kapaciteteve (workshope, trajnime) për kërkuesit dhe udhëheqësit e universiteteve shtetërore dhe private si dhe (iii) të koordinojë e financojë pjesëmarrjen në shërbimet e siguruar.

Propozimi është miratuar dhe po punohet për projektin final që do të paraqitet në tetor 2010.

3. Përdorimi i qëndrueshëm i sistemeve Agro-Silvo-Pastorale në harmoni me ruajtjen e biodiversitetit (Sustainability of Agro-Sylvo-Pastoral Land-Use Systems and their relevance for biodiversity) – SASPLUS, në kuadër të Programit SEE-ERA.NET, me koordinator: Universitetin e Gëtingenit, Gjermani, me bashkëpunëtorë AShSh (Prof. Dr. Arsen Proko) dhe EPRES, Bosnje Hercegovina. (2010-2012).

Projekti planifikon zhvillimin e objektivave kryesorë të sistemeve silvo-pastorale si pjesë e peizazheve heterogjene dhe mozaikut rural që të: (i) investigojë biodiversitetin e Sistemeve Agro-Silvo-Pastorale (ASP) në dy vendet dhe në lartësi të ndryshme mbi nivelin e detit, në nivelin e specieve bimore dhe vegjetacionit (komuniteteve bimore); (ii) vlerësojë ndryshimet në përdorimin e territorit në sistemet ASP në bazë të proceseve historike dhe më të reja duke përdorur remote sensing dhe GIS; (iii) studiojë frekuencat e zjarreve në pyje brenda zonave ASP, si dhe impaktet e tyre në përdorimin e territorit dhe biodiversitetin në mënyrë që të gjendet si ato t'u "mbijetojnë" rrisqeve nga zjarri; (iv) të llogaritet dhe vlerësohet fondi tregtar e jotregtar, të mirat dhe shërbimet që japin sistemet ASP-të e studiuara: lëndë, gjeth, dru zjarri, bimë mjekësore, bimë ushqimore, fruta, kërpudha, blegtori, drithëra, qymyr, kafshë gjahu etj.; dhe (v) studiojë qëndrueshmërinë e aspekteve silvikulturale të sistemeve ASP me fokus në rigjenerimin e specieve drunore dhe strukturën moshore të grumbujve.

Projektpropozimi është seleksionuar në fazën e parë dhe po vazhdon puna për fazën e propozimit të projektit të plotë.

4. Agroushqimi – Ruajtja e specieve autoktone dhe produktet ushqimore tradicionale (AgroFood-Preservation of indigenous species and traditional food products– GERALBMON) në kuadër të Programit SEE-ERA.NET, me koordinator VERNE - FCHE (Gjermani) dhe bashkëpunëtorë AShSh (Prof. Dr. Arsen Proko, Akad. Asoc. Prof. Dr. Efigjeni Kongjika), "Bujqësia Organike" (Dr. Lavdosh Ferruni) dhe GREEN HOME, Mali i Zi, (2010-2012).

Objektivat e projektit janë: (i) të punohet në ruajtjen dhe vlerësimin e kultivarëve të rrallë të bimëve me vlera përdoruese; (ii) të menaxhohen burimet gjenetike të bimëve në interes të popullsisë lokale; (iii) të tregohet kujdes në rritjen e njohurive për kultivimin, traditën dhe përdorimin hapësinor të këtyre bimëve, duke ruajtur trashëgiminë dhe njohuritë e historisë specifike të kultivimit dhe seleksionimit.

Projekti është seleksionuar në fazën e parë dhe po vazhdon puna për fazën e propozimit të projektit.

Gjatë vitit 2009, janë bërë disa ndërhyrje në mënyrë që të përmirësohet menaxhimi dhe të rritet cilësia e shërbimeve.

1. Pasurimi i bibliotekës me libra këtë vit është kryer përmes tri burimesh: a) blerje, b) shkëmbim dhe c) dhurata.

a - Në vitin 2009 fondi i dhënë nga shteti për blerje librash ishte 400 000 lekë, pra 100 000 më shumë sesa në vitet e kaluara (2006, 2008, 2009), kur shuma prej 300 000 lekësh mbulonte edhe pasurimin e tri bibliotekave filiale, të Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Institutit të Kulturës Popullore dhe herë pas here edhe të Institutit të Arkeologjisë. Që në vitin 2005 është bërë propozimi nga Biblioteka që, duke pasur parasysh faktin që vëllimi i botimeve në Shqipëri ka tashmë ritme shumë të larta (sipas shifrave të relatuara nga Shoqata e Botuesve dalin rreth 5 libra në ditë), si edhe çmimit të tyre mjaft të lartë, ky fond duhej të paktën të dyfishohej, çka praktikisht është marrë parasysh nga qeveria me fondin e ri që është ofruar.

Pra, në rrethanat e reja, ky fond përbënte një kontribut me peshë për pasurimin e bibliotekës sonë dhe duhej menaxhuar me kujdes. Është një fakt i rëndësishëm që ky fond u shterua 100%, dhe me të u blenë gjithsej 152 libra, pjesa më e madhe në dy kopje, ndërsa disa libra në gjuhë të huaj, në një kopje. Midis tyre, përbën një risi blerja e titujve shkencorë që përbëjnë vepra referimi për fushat përkatëse të shkencës si vepra për gjuhësinë të Tullio De Mauros dhe Roman Jacobson, të Noam Chomsky dhe Sebeok Thomas, të studimit të Letërsisë nga Umberto Eco, vepra të fushës së shkencave ekzakte si vepra themelore për çështje të mjedisit dhe ndotjes, për menaxhimin e ujërave, për Bioteknologjinë etj.

Një numër të vogël zënë në këto blerje, vetëm 15 %, titujt fiction, kryesisht të shkrimtarëve akademikë ose vepra që kanë bërë jehonë në letërsinë shqipe dhe kanë hapur diskutime duke sjellë vlera të reja, sipas kritikës së specializuar (botime e plota të Kadaresë, Fatos Kongolit etj.).

Librat janë zgjedhur në bazë të propozimeve të akademikëve ose seksioneve përkatëse të Akademisë, me miratimin e sekretarit shkencor, duke u nisur gjithmonë nga kriteret e forta shkencore.

Një lajm i mirë është rikuperimi i koleksionit të revistave *Shejzat*, botuar në Romë për 18 vjet rresht (1957 - 1974) i cili u krye përmes fotokopjimit dhe lidhjes së fortë, si një nismë e stafit të bibliotekës.

b – Për sa i përket përfitimit të literaturës përmes shkëmbimeve, është realizuar marrëveshje shkëmbimi për botimet e Akademisë me rreth 50-60 Institucione shkencore-kërkimore jashtë vendit. Në këtë numër përfshihen edhe disa adresa personalitetesh, që konsiderohen si albanologë të shquar dhe të cilët marrin, sipas fushës që mbulojnë, veprat ose periodikët e botuar nga Akademia (p.sh., Fidler, Eric Hamp etj.), por që gjithashtu dërgojnë punimet dhe informacionet e tyre në këtë bibliotekë.

Këtë vit janë dërguar për shkëmbim disa tituj, botime të Akademisë: 19 tituj, monografi shkencore ose fjalorë (*Enciklopedia shqiptare, Shpallja e pavarësisë, Historia e qytetërimit shqiptar, Një jetë kushtuar shkencës, Bibliografi e artikujve gjuhësorë, Vështrim për përdorimin e metodave, Formimi i foljeve në gjuhën shqipe, Udhë e shkronjave, Rreth leksikut politik-shoqëror, Prapavendosja e njëjës, Estetika metateorike v. 1, Estetika metateorike v. 2, Fjalor i gjuhës shqipe, Leksiku dialektor dhe krahinor, Veçoritë leksiko semantike, Kongresi i Manastirit, A. Buda Kujtime, Albumi Veshje popullore v. 3.*); 2 periodikë: *Studia Albanica, 2008* dhe *Iliria nr. 32*, si edhe 2 vepra të tjera, *Harta Arkeologjike e Shqipërisë* (varianti shqip dhe frëngjisht) dhe *Arti shkëmbor në Shqipëri*, të cilat praktikisht janë vepra me kontribut të akademikëve, të mbështetura financiarisht nga Organizata ndërkombëtare, por që me dashamirësi iu vunë në dispozicion Bibliotekës sonë.

Ndërkaq kanë ardhur në bibliotekë si shkëmbim rreth 200 vepra, një pjesë e madhe me karakter filologjik dhe një pjesë tjetër periodikë shkencorë, botime të akademive përkatëse me të cilat kemi lidhje.

Këtë vit u krijuan edhe koleksionet e lidhura të *Fletoreve zyrtare* (nga viti 2007), si edhe të *gazetave* (viti 2008).

c – Pasurimi i fondeve nëpërmjet dhuratave është një tjetër mënyrë e mirëpritur, por jo gjithmonë e efektshme. Përgjithësisht stafi i bibliotekës ka qenë shumë selektiv në pranimin e librave dhuratë.

2. Problem serioze që është hasur edhe gjatë vitit 2009 ka qenë ai i *pasurimit të bibliotekës me periodikët shkencorë*. Buxheti në Euro për blerjen dhe pajtimin në revista të huaja shkencore, me faktor të fuqishëm impakti, ka qenë i papërfillshëm. Si rrjedhim, mundësia e bibliotekës për të ruajtur dhe për të rritur koleksionet e veta është ulur ndjeshëm. Tashmë ne marrim vetëm tituj periodikësh, të cilat vijnë përmes rrugës së shkëmbimit. Por është e natyrshme që jo gjithmonë janë ato titujt më të mirë. Këto tituj janë më tepër të fokusuar në shkencat shoqërore (më shumë arkeologji, histori, gjuhësi, probleme letrare) dhe më pak tek ato ekzakte. Problemet e krijuara nga çmimet në rritje të periodikëve janë të shoqëruara nga rritja e madhe e sasisë së informacionit të botuar. Numri i titujve të rinj të revistave shkencore rritet çdo vit. Për më tepër, vënia në dispozicion e indeksit elektronik e ka rritur shumë numrin e burimeve të identifikueshme nga përdoruesit e bibliotekës, kështu që kërkesat kanë qenë të shumta, për përfshirjen e tyre në koleksionet e bibliotekës. Nuk është e nevojshme të theksohet rëndësia që bibliotekat hulumtuese duhet t'i kushtojnë qasjes gjithëpërfshirëse ndaj literaturës periodike për mbështetjen e kërkimit shkencor. Në këto kushte, propozojmë të kalojmë në pajtime online, të cilat të jenë të disponueshme në sallën e bibliotekës. Kjo arrihet me një kosto më të ulët ekonomike dhe ndërkaq me një pasurim të vërtetë të bibliotekës. Gjithashtu propozojmë që të gjitha monografitë shkencore, të botuara nga Akademia e Shkencave, përveç një tirazhi të limituar që do të kenë në letër, të jenë të shitshme edhe në rrjetin e internetit.

3. Digjitalizimit i BA-së, Në shoqërinë moderne të informacionit, shndërrimi i shërbimeve në përputhje me teknologjitë e reja është një detyrë e dorës së parë për një shërbim sa më efektiv ndaj lexuesit. Mundësia për të krijuar edhe bibliotekën digjitale, krahas asaj tradicionale, pra për të arritur në katalogimin online të Fondit të Bibliotekës, përbën sot një nga strategjitë kryesore në rrugën e zhvillimit të bibliotekave.

Këtë vit në BA ka një risi të madhe, e cila doemos do të ketë një impakt të fortë në gjallërimin dhe komunikimin më të mirë me lexuesit. Janë marrë të gjitha masat që në saje të projektit të IPA, BA të pajiset me tri kompjuterë të rinj duke krijuar kështu një bazë materiale të konsiderueshme (4 kompjuterë, 2 printer, një server) që përbën një kusht të rëndësishëm për t'u finalizuar detyra e digjitalizimit të BA. Në sallën e bibliotekës do të instalohen dy kompjuterë me lidhje në internet, si edhe të pajisur me bazën ekzistuese të të dhënave të katalogut online. Kësisoj, çdo lexues i interesuar mund të bëjë kërkimet e veta, jo vetëm për të mësuar nëse libri i kërkuar gjendet në BA, por edhe për të marrë informacion më të plotë se çfarë është shkruar rreth temës në fjalë.

Në kuadrin e rikonceptimit të faqes zyrtare të Akademisë së Shkencave, nga stafi i Bibliotekës është përgatitur zëri për bibliotekën dhe zëri i botimeve dhe, për këtë vit, në marrëveshje me Kryesinë e Akademisë, është vendosur të kalohet në nënfaqen e Bibliotekës, e cila do të përmbajë katalogun online të BA.

4. Marrëveshjet ndërkombëtare të BA. Gjatë vitit 2009 ka vazhduar me sukses realizimi i marrëveshjes me CEOOL, pra afishimi i dy numrave të revistës *Studia Albanica* në faqen e kësaj Biblioteke të rëndësishme. Ndërkaq një marrëveshje e re është lidhur me rrjetin më të fuqishëm të bibliotekave online, EBSCO, i cili pasi vlerësoi në komisione mjaft të specializuara dy revistat e Akademisë, *Studia Albanica* dhe *AJNTS*, na propozoi t'i afishojnë në siti-n e tyre. Pa dyshim, ky është një afirmim i vlerave të këtyre revistave edhe në një plan të ri, atë ndërkombëtar.

Me nismën e Sekretarit shkencor, nga ana e stafit të bibliotekës, u arrit të merret edhe numri “ISSN” i të dy revistave. Ndërkaq po përgatiten të gjitha praktikat e duhura për të fituar nga autoritetet përkatëse ndërkombëtare edhe faktorin e impaktit për këto revista. Sipas opinionit tonë, janë të gjitha gjasat që kjo të arrihet brenda tremujorit të parë të 2010.

Një marrëveshje tjetër është lidhur me Universitetin e Kalabrisë, për shkëmbimin e tezave të doktoraturës të mbrojtura në institucionet përkatëse.

5. Një nga prioritetet e BA ka qenë dhe do të do të jetë edhe *Informimi*, i cili i është vënë në dispozicion lexuesit përmes Newsletter në çdo tre muaj. Gjithashtu është shtuar edhe informimi për periodikët, me një informacion të hollësishëm rreth argumentit, autorëve dhe përmbajtjes së periodikëve në përgjithësi.

6. BA ka zhvilluar edhe *veprimtari shkencore* që ka ndikuar në kualifikimin e stafit dhe përmirësimin e shërbimit. Vlen të përmendet pjesëmarrja në Konferencën e COBISS-it (Sistemi i përbashkët i informacionit dhe shërbimeve bibliografike) që u organizua nga Instituti i shkencave të informacionit (IZUM), me qendër në Maribor (Slloveni). Ky Institut prej një çerek shekulli po zhvillon dhe mirëmban një sistem të tillë të përbashkët të informacionit dhe shërbimeve bibliografike, ku aderojnë më shumë se 500 biblioteka nga vende të Ballkanit perëndimor si: Sllovenia, Serbia, Bosnje-Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi, Bullgaria, ndërsa pritet të përfshihet Kroacia, si edhe Shqipëria dhe Kosova. Projekti, si dhe pjesëmarrja në të, duket me mjaft interes, duke analizuar të gjitha ato përparësi që ofron, të cilat u përmendën më sipër. Përveç këtyre avantazheve, duhet vënë në dukje se konvertimi i bazës të të dhënave bibliografike dhe përfshirja e saj në bazën e përbashkët, kërkon një farë shpenzimi, si p.sh. regjistrimi i çdo rekordi; po kështu dhe krijimi i mundësisë për akses nga secili kompjuter, në bazën e përbashkët, kërkon pagesën e një tarife të vogël monetare mujore. Stafi i Bibliotekës ka marrë pjesë rregullisht në seminarët përditësuese të organizuara nga BK.

Drejtuesja e BA, Mariana Ymeri, është ndërkaq titullare e lëndës së bibliotekonomisë në Fakultetin e Filologjisë, si edhe drejtuese e masterit të editorisë po në këtë fakultet. Këtë vit ajo ka qenë drejtuese e tri diplomantëve, me tema nga Gramatika e shqipes si edhe nga Bibliotekonomia.

Si sekretare shkencore e Kolegjiut të revistës *Gjuha Jonë*, tashmë organ i Qendrës së Studimeve Albanologjike, M. Ymeri ka përgatitur për botim numrin 1-4 të vitit 2008, të kësaj reviste.

M. Ymeri ka marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare për Çështjet e Gjuhës shqipe, organizuar në Ohër, me kumtesën *Rreth strategjive të përdorura në komunikimin në chat*. Gjithashtu ka përkthyer në vitin 2009 librin *Leksioni i parë për gjuhën*, shkruar nga Tullio De Mauro, si edhe *Historia e Librit dhe e botimit*.

V. BOTIMET

Për të stimuluar botimin e studimeve më të arrira të anëtarëve të akademisë dhe të komunitetit më të gjerë shkencor, pranë Kryesisë së Akademisë funksionon Këshilli i Botimeve. Që në fillim të vitit 2009, në zbatim të nenit nr. 28 të Statutit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë “**Për Këshillin e Botimeve**”, Këshilli Ekzekutiv miratoi rregulloren e funksionimit të tij. Sipas Statutit, Këshilli i Botimeve është organ që përpunon politikën e botimeve të ASH, në përputhje me programet shkencore të Asamblesë të Akademisë, duke përcaktuar kriteret themelore për botimet e Akademisë.

Këshilli i Botimeve, me 14 akademikë, i riformuar në fillim të marsit pas reformës në ASH, kryesohet nga Kryetari i Akademisë dhe përbëhet nga studiues të kualifikuar të fushave kryesore të

veprimtarisë botuese shkencore të Akademisë dhe jashtë saj. Këshilli ka përcaktuar përparësitë e botimeve nga fusha të ndryshme të shkencës, duke ngulmuar në vepra të rëndësishme ndërdisiplinore ose me rëndësi të veçantë kombëtare, si edhe në varësi të buxhetit të akorduar për botimet. Duhet theksuar se ky fond për vitin 2009 ka qenë më i ulët se ai i vitit 2008. Konkretisht, kanë dalë nga shtypi veprat e poshtëshënuara:

- *Fjalori Enciklopedik Shqiptar, FESH, (Botim i ri)*, Vëll 1 dhe 2 dhe është në botim Vëll. 3; **Akademia e Shkencave;**

- **Pano N. 2009 Pasuritë ujore të Shqipërisë**. f.482;

- *Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe, probleme e detyra (përmbledhje e Konferencës Shkencore);*

- *100-vjetori i Kongresit të Manastirit (përmbledhje e Konferencës Shkencore);*

- *Eqrem Çabej dhe vendi i tij në shkencat albanologjike – 100-vjetori i lindjes së tij (përmbledhje e Konferencës Shkencore).*

Gjithashtu, një sërë titujsh janë depozituar pranë degës së botimeve, nga autorë të ndryshëm për fusha të ndryshme të kërkimit.

Dega e Botimeve, që varet nga Dega e Financës dhe Administratës ka përgatitur për shtyp dhe ka ndjekur botimin e veprave, si monografi, përmbledhje të konferencave, vepra seriale etj., që janë të miratuara dhe në përputhje me vendimet e Këshillit të Botimeve të Akademisë; ka ndjekur botimin e organeve periodikë, që përgatiten nga redaksitë përkatëse: të *Albanian Journal of Natural and Technical Sciences* (AJNTS) dhe *Studia Albanica*. Si për botimet periodike ashtu dhe për veprat e tjera, Dega e Botimeve në bashkëpunim me Degën e Financës dhe me autorët ka realizuar përgatitjen e dokumentacionit përkatës për Këshillin Botues, përgatitjen e veprave për botim dhe ka ndjekur botimin në shtyp në të gjitha hallkat e tij.

Gjatë vitit 2009, revista *Albanian Journal of Natural and Technical Sciences* ka dalë në dy numra me artikuj origjinale të autorëve të vendit dhe të huaj nga fushat e shkencave natyrore e teknike. Në revistën *Studia Albanica* janë botuar studime të përzgjedhura të shkencave shoqërore e albanologjike, duke përfshirë dhe kontribute të studiuesve të trojeve të banuara nga shqiptarë, të diasporës dhe të studiuesve të huaj, të cilët hulumtojnë në fushën e shkencave shqiptare.

Gjithashtu Dega e Botimeve ka dhënë një kontribut të veçantë në përgatitjet grafike (dizenjime të banderolave, posterave, ftesave, etj.) për veprimtaritë e zhvilluara nga ASH.

Nga Dega e Botimeve është organizuar edhe pjesëmarrja në panairët e librit, që konsiderohen si vitrina të botimeve të reja e promovimesh. Këtë vit, ASH ka marrë pjesë me përfaqësuesit e vet dhe me stenda dinjitoze në katër panaire, Panairin Ndërkombëtar të Shkupit, Panairin e librit në Prishtinë, panairin e librit në Ulqin, dhe Panairin e librit në Tiranë.

VI. FUQIZIMI I INFRASTRUKTURËS, TEKNOLOGJIVE TË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Forcimi i infrastrukturës të ASH-së është gjithashtu i rëndësishëm në kushtet e reja të saj, kur nuk trashëgon më atë konfigurim dhe disponim të mjeteve që kishte më parë me kalimin e institucioneve dhe qendrave shkencore pranë universiteteve.

Ndër veprimtaritë më të rëndësishmet në këtë drejtim, gjatë vitit 2009 kanë qenë: rritja e kapaciteteve të infrastrukturës informatike (LAN); rikonfigurimi i shërbimit të Internetit me kapacitete të përmirësuara për të përballuar planin e zhvillimit afat shkurtër; rritja e kapaciteteve të infrastrukturës (hardware dhe software); plotësime në BA për realizimin e rikonfigurimit të bibliotekës shkencore në një qendër të promovimit e transferimit të informacionit shkencor e teknologjik dhe përmirësimin të mënyrave të shpërndarjes së informacionit në të gjitha nivelet

përkatëse e stimulimin e publikimeve elektronike; rritja e kapaciteteve të NjPKZhI, drejt përmirësimit të cilësisë së menaxhimit të programeve e projekteve, bazuar në manualet e sistemeve europiane në përputhje me programet e ndryshme, të cilat duke u përditësuar hap pas hapi me strategjitë, politikat, prioritetet e KZh dhe iniciativat e BE janë ndër marrë procedura të modifikimit e sugjerimit të politikave e prioritetëve të kërkimit, për t'i harmonizuar me politikat Europiane dhe me përmbushjen e objektivave kombëtare të KZh.

Në përmirësimin e infrastrukturës së AShSh është koordinuar që të jetë e pranishme dhe asistencë e organizmave homologe në botë për forcimin dhe rritjen e efektivitetit të AShSh-së. Vazhdon zhvillimi i veprimtarive të Projektit "Empowering of Academy of Sciences of Albania - Strengthening their Advisory Capacity" të mbështetur nga TWAS (Rrjetin Ndërkombëtar të Akademive në Zhvillim).

Fuqizimi i Akademisë së Shkencave dhe forcimi i rolit të saj, do të ketë impakt brenda dhe jashtë vendit: në vetë Akademinë e Shkencave, në bashkësinë e komunitetit shkencor, në arsim në të gjitha nivelet e universitetet, në edukimin shkencor të brezit të ri, në qeverisjen e vendit në spektrin politiko-ekonomik, në zhvillimin ekonomik, në shoqërinë civile, në kompanitë private, shoqëritë jo fitim prurës si dhe jashtë vendit: në Rrjetin e Akademive të Europës Jug-Lindore, InterPanelin e Akademive të Botës etj.

PJESA E KATERT

PËRPARËSITË E ASH PËR VITIN 2010

Gjatë vitit 2010 Seksionet, sipas problematikave në fushat prioritare, do të krijojnë grupe të përhershme ose *ad-hoc* multidisiplinore të përbëra nga specialistë të fushave nga universitetet, institucionet e kërkimit dhe sektori privat për të identifikuar e konsultuar e ofruar zgjidhje për probleme të veçanta, që qëndrojnë përpara vendit sot e për të ardhmen, në fushat e arsimit e të shkencës, të ujit, energjisë, emergjencave civile, bujqësisë dhe ushqimit, bioteknologjive e biosigurisë, biodiversitetit, shëndetësisë e kualitetit të jetës, teknologjive të informacionit e komunikimit mjedisit, gjuhësisë, historisë, trashëgimisë kulturore, sociologjisë, ekonomisë, financës dhe problemeve demografike etj., për një zhvillimin të qëndrueshëm të vendit. Do të veçonim me prioritet reformimin e komisionit mbarëkombëtar të gjuhës shqipe. Gjithashtu, planifikohet një program i detajuar për hartimin e *Enciklopedisë Shqiptare*, si një vepër e munguar në shoqërinë shqiptare.

Do të stimulohet më tej lidhja me universitetet e vendit (shtetërore e private) për forcimin e mësimdhënies me kërkimin shkencor.

Kërkuesit e rinj do të jenë në vëmendje të ASh nëpërmjet krijimit të strukturave të reja, përmes të cilave do të mundësohet organizimi i shkencëtarëve të rinj në forume, në përputhje edhe me modelet e akademive të ALLEAs të përshtatura për kushtet e vendit tonë.

Duke pasur parasysh që Akademia nuk e luan rolin e vet siç duhet, nëse ajo nuk i bën të njohura si aktivitetet edhe rezultatet e veta shkencore edhe në publikun e gjerë, programi i veçantë i veprimtarive për edukimin në shkencë me të gjitha moshat, do të përbëjë një prioritet të ASh në të ardhmen, ku do të përfshihet bashkëpunimi me aktorë të mësimdhënies në të gjitha nivelet. Në këtë veprimtari edhe në të ardhmen do të organizohen e masivizohen më tej, jo vetëm në Tiranë, *ditët e hapura të institucioneve shkencore për studentët*.

Bashkëpunimi ndërmjet shkencëtarëve në institucionet brenda e jashtë vendit, do të mbështetet nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimtari të përbashkëta (projekte, konferenca, seminare, tavolina të përbashkëta, etj.).

Prioriteti i kërkimit shkencor do të jetë lidhja dhe zbatimi i produktit të kërkimit në biznes, në zbatim të konventës së Lisbonës, sipas së cilës reforma e KZHTI duhet të synojë reformimin e sistemit financiar drejt mekanizmave të ekonomisë së tregut. Vendosja e mekanizmave të kooperimit ndërmjet kërkimit dhe industrisë, nëpërmjet aplikimit të përbashkët në programe të kërkimit e zhvillimit, do të jetë thelbësore në veprimtaritë e AShSh. Kohët e fundit shfaqet tendenca alternative për forcimin e inovacionit të NVM-ve. Ky fakt duhet pasur në konsideratë në propozimin e partnershit në kuadër të aplikimeve të projekteve, që mendojmë se mbetet prioriteti i punës sonë në të ardhmen.

Nxitja e kërkimit shkencor nga biznesi do të jetë promotor i investimeve të sektorit privat në kërkim, ku synohet ngritja e bërthamave e institucioneve shkencore të reja, për të cilat po punohet që prej vitit 2009. Kontributi i biznesit në kërkim është sfida e zhvillimit të sigurt e të shëndetshëm të shkencës, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit në Shqipëri. Promovimi i rolit vital të sektorit privat në zhvillimin e KZHTI në vend, duhet kuptuar si *gjeni* i inovacionit. Një kombinim i mirë i politikave qeveritare me strategjitë e biznesit është vendimtar në krijimin e një mjedisi të favorshëm për të gjeneruar novacion.

Parashikohen veprimtari të shpeshta informimi të AShSh për mbarë komunitetin shkencor e shoqërinë civile (si kumtime, informime e veprimtari promovuese, etj. në sallën e AShSh). Për këtë qëllim, në kuadër të projektit IAP, do të ristrukturohet Salla shkencore e Bibliotekës së Akademisë, do të krijohet infrastruktura e nevojshme për Akademikët (duke u krijuar akses personal dokumentar), do të vihet në funksionim një rrjet informatik me tre kompjuterë për shërbime Interneti me kapacitet të lartë dhe kërkim skedarësh etj.

ASHSh vlerëson si prioritare, gjithashtu, futjen e treguesve statistikorë në kërkimin shkencor në përputhje me standardet ndërkombëtare, për të cilat ajo parashikon që në bashkëpunim me MASH, e institucione të tjera që lidhen me këtë problem (INSTAT), të japë kontributin e vet.

Përpjekjet për hapjen e fushave të reja të kërkimeve do të ecin paralelisht edhe me përpjekjet për ngritjen e nivelit të kërkimit në fushat ekzistuese, nëpërmjet monitorimit e vlerësimit në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Në përputhje me prioritetet e Qeverisë, në përgjigje të kërkesës së Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, ASh do bashkëpunojë për hartimin e projekteve për rehabilitimet në zonat e përmytura. Janë paraqitur disa propozime, të cilat pritet së shpejti të vlerësohen për t'u vënë në jetë nga MMPAU. Gjithashtu, ASh do të përgatisë një përmbledhje studimi në lidhje me orientimet e fundit të Qeverisë, për zbatimin e kontrollit dhe monitorimit të digave (me prioritet atyre të mëdha), të Kupave të rezervuarëve dhe të sigurisë së shpateve (në ato raste kur ato janë problematike).

Megjithëse është bërë progres i dukshëm në drejtim të hartimit të politikave, strategjive dhe ligjeve për sistemin e KZh, vihen re akoma mangësi në drejtim të kuadrit legjislativ lidhur me “përhapjen e shkencës dhe teknologjisë”, “nxitjen e komercializimit të arritjeve në shkencë dhe teknologji”, apo në rinovimin e vetë ligjit të shkencës, teknologjisë dhe inovacioneve. Për këtë qëllim, ASh e sheh të rëndësishme dhënien e kontributeve në përmirësime të mëtejshme të legjislationit për kërkimin shkencor e menaxhimin e tij me efikasitet.

Për ASH është e rëndësishme vendosja e një dialogu konstruktiv e të vazhdueshëm me organet qeveritare për rritjen graduale të fondeve të caktuara për kërkim e zhvillim, në mënyrë që edhe për këtë tregues vendi të ecë krahas me vendet të tjera të Bashkimit Evropian, ku synojmë të aderojmë së shpejti. Krijimi i Agjencisë për Shkencën Teknologjinë dhe Inovacionin do të krijojë kushte për miradministrimin e rritjen e autonomisë së projekteve nga burokracia e sistemit financiar, duke ju

përqasur sa më tepër me praktikat e Bashkimit Evropian. Politikat e KZh duhet të ndryshojnë nga “politikat e sigurimit të fondeve” tek politikat e “stimulimit për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin”.

Parashikohen që për vitin 2010 të zhvillohen një numër projektsh ndërkombëtare, të cilat janë përzgjedhur në fazën e shprehjes së interesit dhe pritet miratimi i projekt-propozimeve të tyre, të cilat përfshijnë fusha të ndryshme të KZH. Gjithashtu, do të zhvillohen edhe projektet në kuadër të bashkëpunimit me Kosovën, një pjesë e të cilave janë përgatitur gjatë vitit 2009.

Do të organizohen edhe një sërë konferencash kombëtare e ndërkombëtare, që trajtojnë probleme prioritare dhe paraqesin rezultatet më të mira të kërkimit shkencor në vend, ndër të cilat do të veçohim: (i) Tryezë shkencore ***Për kritikën letrare***. AShAK (SGjL) në bashkëpunim me AShSh (SShSHA), QSA; (ii) ***Konferencën Ndërkombëtare Menaxhimi Shëndetësor në Shqipëri dhe Kosovë: - Sfida Madhore të Sistemeve Shëndetësore në Tranzicion***. AShSh (SShNT Fakulteti i Mjekësisë, QSUT) dhe AShAK (SShN), Tiranë 2010; (iii) ***Konferencën Shkencore të Algjebrës dhe Analizës Funksionale***, organizuar nga AShSh (SShNT) dhe AShAK (SShN), Universiteti “Aleksandër Xhuvani” i Elbasanit, Elbasan, 2010; (iv) ***Konferencën Zhvillimi i Teknologjive të Informacionit: Teoria dhe Teknologjia*** AShSh (SShNT; Fakulteti i Teknologjive së Informacionit - UPT) dhe AShAK (SShN), Tiranë, 2010; (v) ***Konferencën Liqeni i Shkodrës dhe problematikat e lidhura me të*** AShSh dhe AShAM nën kujdesin e të dy Presidentëve, të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Malit të Zi. Podgoricë dhe Shkodër, 2010 etj.

Janë planifikuar edhe veprimtari të ndërsjella bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare, si vizita e Presidentit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të malit të Zi, Presidentit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Turqisë, Zv-presidentit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë; vizita të Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në Akademinë Turke, në Akademinë Leopoldina të Gjermanisë, etj.

Prioritet edhe për vitin 2010 do të mbetet botimi i veprave me vlera të veçanta shkencore të Akademikëve dhe të studiuesve më në zë që kryejnë veprimtari brenda e jashtë vendit.

Deri tani janë depozituar në degën e Botimeve monografite e mëposhtme:

- Alfred Uçi - *Filozofia e Don Kishotit*

- Josif Papagjoni - *Historia e Teatrit Shqiptar*

- Rustem Zenelaj, Elvira Çausi - *Koleksioni i majave industriale (katalogu i kulturave)*

- Vasil S. Tole - *Fjalor etnomuzikologjik i muzikës popullore homofonike të Shqipërisë së*

Veriut

- Emin Riza - *Banesa popullore shqiptare*

- Apollon Baçe, Aleksandër Meksi, Emin Riza - *Berati, historia dhe arkitektura*

- Salvatore Bushati, Vilson Silo - *Gjeofizika e zbatuar*

- Dhimitër Haxhimihali - *Histori e prodhimit kimik në Shqipëri*

- Feride Papeleka - *Dhimitër Shuteriqi, Aventura e një vepre totale*

- Alfred Uçi - *Migjeni - fryma moderne në letërsinë shqipe*

- Iljaz Gogaj - *Një shekull shkollim shqip (album)*

- Kolec Topalli - *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*

- Dhimitër S. Shuteriqi - *Provë e një fjalori parabuzukjan të shqipes (1989)*

- Shaban Sinani - *Kodikët e Shqipërisë në “kujtesën e botës”*

- Muzaffer Korkuti - *Qytetërimi neolitik dhe eneolitik në Shqipëri*

- Eduard Sulstarova - *Sizmiteti dhe vlerësimi probabilitar i rrezikut sizmik në Shqipëri.*

Po kështu do të vazhdojë botimi i periodikëve *AJNTS* dhe *Studia Albanica*.

Në përfundim, po theksojmë që Akademia e Shkencave, pas reformimit të saj, po synon një nga atributet kryesore, prestigjin e lartë, i cili ka një rol themelor, në udhëheqjen e kërkimit shkencor e

kursimin e kostove të informacionit, si dhe përbën një avantazh në konkurrimin për cilësi të lartë në shoqërinë shqiptare.

SHTOJCA 1

Artikuj popullarizues dhe intervista në masmedia

I - Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike

- **Beci B., *Shqiptarët e Maqedonisë, më të hershëm se sllavët.*** *Gazeta Shqiptare*, 23 Shtator 2009, ribotuar nga disa gazeta në Shqipëri, Maqedoni dhe Kosovë;
- **Beci B., *Një optimist për Akademinë.*** *Gazeta Shekulli*, 1 shkurt 2009;
- **Beci B., *Shqipja Standarde.*** Emisione televizive (*RTSh, Ora News*);
- **Riza E., *Banesa tradicionale gjakovare,*** *Univers*, 2009/11;
- **Riza E., *Qemal Butka, një figurë e spikatur e arkitekturës shqiptare.*** *Ndërtuesi*, nr. 68/2009;
- **Tirta M., *Dukuri të etnokulturës persiane ndër Shqiptarë,*** *Revista Perla*, Tiranë, 2009, nr.1, fq.122-130;
- **Tirta M., *Migrime të popullsisë fshatare malësore drejt viseve paraurbane e urbane (1991-2007),*** *Revista Demografia*, Tiranë, 2009, nr.1, fq. 46-59;
- **Tirta M., *E drejta dokesore shqiptare në vështrim etik e kultik*** (Sipas trajtimit të studiuesit japonez Kazuhiko Jamamoto), *Revista Univers*, Tiranë, 2009, nr.11, fq.113-123. Botuar dhe në *Hylli i Dritës*, Shkodër, 2009, nr.3, fq. 43-55;
- **Topalli K., *Etimologjia e emrit Tiranë.*** Intervistë televizive, *TV Koha*, Tiranë, 5. 1. 2009;
- **Topalli K.,** Simpoziumi Ndërkombëtar *Veprat më të mira në albanologji.* Intervistë televizive, *TV Calvin*, Tiranë, 6. 1. 2009;
- **Topalli K., *Akademia e Shkencave.*** Emisioni 7x7, *TVSH (Televizioni Publik Shqiptar)*, Tiranë, 26. 1. 2009;
- **Topalli K., *Akademia e Shkencave.*** Intervistë televizive. *TV Vizion Plus*, Tiranë, 30. 1. 2009;
- **Topalli K., *Akademia e Shkencave.*** Intervistë radiofonike. *ATSH (Agjensia Telegrafike Shqiptare)*, Tiranë, 2. 2. 2009;
- **Topalli K., *Akademia e Shkencave.*** Intervistë radiofonike. *RTSH (Radio Televizioni Shqiptar)*, Tiranë, 4. 2. 2009;
- **Topalli K., *Akademia e Shkencave.*** Intervistë radiofonike. *RTSH (Radio Televizioni Shqiptar)*, Tiranë, 5. 2. 2009;
- **Topalli K., *Akademia e Shkencave.*** Intervistë televizive. *TVSH (Radio Televizioni Shqiptar)*, Tiranë, 5. 2. 2009;
- **Topalli K., *Akademia e Shkencave.*** Intervistë televizive. *NTV (Nesër TV)*, Tiranë, 5. 2. 2009;
- **Topalli K., *Gjuha shqipe dhe shkolla.*** *Tryezë e rrumbullakët RTSH.* Tiranë, 5. 3. 2009.
- **Topalli K., *Probleme të standardit të gjuhës shqipe në epokën tonë.*** Intervistë televizive. *Televizioni Koha*, Tiranë, 6. 5. 2009;
- **Topalli K., *Standardi i shqipes.*** Intervistë televizive. *Televizioni Top News*, Tiranë, 6. 5. 2009;
- **Topalli K., *Një jetë kushtuar albanologjisë.*** Intervistë televizive. *Televizioni ALSAT.* Tiranë, 5. 6. 2009;
- **Topalli K., *Selman Riza në 100-vjetorin e lindjes.*** Intervistë televizive. *TVSH (Televizioni Shqiptar)*. Tiranë, 25.7.2009;
- **Topalli K., *Pikëpamjet antishqiptare në Enciklopedinë Maqedonase.*** Intervistë televizive. *Televizioni "Vizion plus"*. Tiranë, 21.9.2009;

- **Topalli K.,** *Për Enciklopedinë Maqedonase.* Tryezë e rrumbullakët televizive. *Televizioni i Maqedonisë.* Shkup, 24. 9. 2009;
- **Topalli K.,** *Për monografinë Sistemi rasor i emrave të shqipes.* Intervistë televizive. *TVSH (Televizioni Shqiptar).* Tiranë, 22. 10. 2009;
- **Topalli K.,** *Për 100-vjetorin e lindjes së Selman Rizës.* Intervistë radiofonike. *RT (Radio Tirana),* Tiranë, 13. 12. 2009;
- **Topalli K.,** *Për monografinë Sistemi rasor i emrave të shqipes.* Intervistë televizive. *TVSH (Televizioni Shqiptar).* Tiranë, 15. 12. 2009;
- **Topalli K.,** *Për standardin e gjuhës shqipe.* Emisioni 7 x 7. *TVSH (Televizioni Shqiptar).* Tiranë, 21. 12. 2009;
- **Topalli K.,** *Përgatitja e një brezi të ri shkencëtarësh është domosdoshmëri.* *Rilindja Demokratike,* Tiranë, nr. 5214, 4. 1. 2009, f. 15;
- **Topalli K.,** *U ndjeva mirë që çmimin ma dorëzoi Eric Hamp;* *Kult,* Tiranë, nr. 273, 21. 1. 2009; f. 20-21;
- **Topalli K.,** *Përfaqësuesit e elitës kanë bazë shkodranishten.* *Gazeta Shqiptare.* Tiranë, nr. 4530, 3. 4. 2009, f. 24-25;
- **Topalli K.,** *Teza të reja për nyjat e shqipes.* *Gazeta Shqip.* Tiranë, nr. 198 (1209), 22. 7. 2009, f. 28;
- **Topalli K.,** *Intervistë me akademikun Kolec Topalli rreth librit Nyjat e shqipes.* *Gazeta Metropol,* Tiranë, nr. 1812, 25. 7. 2009, f. 11;
- **Topalli K.,** *Ju tregoj evolucionin e nyjave në gjuhën shqipe.* *Gazeta 55,* Tiranë, nr. 193 (3913), 2. 8. 2009, f. 14;
- **Topalli K.,** *Historia duhet të rishkruhet, në mënyrë që të mos ndryshohet më.* *Gazeta Telegraf,* Tiranë, 5. 8. 2009, f. 10-11;
- **Topalli K.,** *Shkup, një tryezë albanologësh për Enciklopedinë maqedonase.* *Gazeta Shqiptare,* Tiranë, nr. 4706, 28.9.2009, f. 18;
- **Tole V.,** *Edukimi përmes muzikës,* *Gazeta Panorama,* 21 qershor, 2009.

II - Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike

- **Frashëri A. & Bushati S.,** *Edhe në Shqipëri, nisma pozitive të shfrytëzimit të energjisë gjeotermale.* *Gazeta Integrimi,* faqe 9, 20 nëntor 2009;
- **Frashëri A. & Bushati S.,** *Të mos vonohemi në projektimin e shtëpive me energji zero.* *Gazeta Integrimi,* faqe 13, 30 nëntor, 2009;
- **Frashëri A. & Bushati S.,** *Ja një platformë për shfrytëzimin e energjisë gjeotermale në Shqipëri.* *Gazeta Integrimi,* faqe shkencë 13, 28 tetor 2009;
- **Frashëri A. & Bushati S.,** *Pse nxehtësia e tokës si energji alternative duhet shfrytëzuar edhe në Shqipëri.* *Gazeta Integrimi,* faqe shkencë 13, 27 tetor 2009;
- **Frashëri A. & Bushati S.,** *Vlerësime të efektivitetit ekonomik të shfrytëzimit të energjisë gjeotermale.* *Gazeta Integrimi,* faqe shkencë 13, 29 tetor 2009;
- **Haxhimihali Dh.** *Profili i një akademiku.* *Gazeta Integrimi,* 28 nëntor, 2009;
- **Haxhimihali Dh.** *Veprimtaria e Seksionit të Shkencave natyrore e teknike mbas reformimit të ASH.* *Kanali Ora News,* tetor 2009;
- **Proko A.** *Efektet kurative dhe bimët medicinale.* Emision televiziv, Top Show, Televizioni Top Channel, tetor 2009;
- **Proko A.** *Profili i shkencëtarit: veprimtaria shkencore e Prof.Dr. Arsen Prokos.* *Gazeta Integrimi,* faqe 9, dhjetor, 2009.

SHTOJCA 2

Veprimtaritë e mbështetura nga Dega e marrëdhënieve me jashtë dhe me publikun gjatë vitit 2009:

Kongrese, Konferenca e Seminare:

- Seminari i organizuar nga IAP, "Përvojat më të mira në rolet këshilluese dhe në dhënien e bursave", Trieste të Italisë, 12-13 shkurt 2009;
- Seminari i organizuar nga ALLEA-s "Drejt kodit European të sjelljes në Integrimin Shkencor", Bernë të Zvicrës, 29-30 qershor 2009;
- Seminari i organizuar nga Universiteti i Zagrebit, "Roli i vlerësimit dhe klasifikimit të universiteteve në kulturën e cilësisë". Dubrovnik, 2-4 korrik 2009;
- Seminari "Arsimi dhe kultura DG" në bashkëpunim me Universitetin e Firences dhe Universitetin e Shkupit, FYROM, 28-29 shtator 2009;
- Kongresi i 10-të Ndërkombëtar i AIESEE, Paris, Francë, 23-26 shtator 2009;
- Konferenca Ndërkombëtare "Vlerat dhe shekulli i 21-të", organizuar nga Këshilli Ndërkombëtar i Shkencës, Rrjeti i Akademive të Europës Qendrore dhe Lindore, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi, Podgoricë, Mali i Zi, 29 shtator 2009;
- Konferenca Ndërkombëtare "Shkenca Kompjuterike '09", organizuar nga Universiteti Teknik i Sofies, Bullgari; 5-6 nëntor 2009;
- Konferenca Ministrore mbi Infrastrukturën e Informacionit për Shkencën, Arsimin dhe Kulturën, Maribor, Slloveni, 11-12 Nëntor 2009;
- Konferenca e Jashtëzakonshme e ALLEA-s, Amsterdam, Holandë, 16-17 nëntor 2009.

Takime protokollare

- Takim për përgatitjen e Protokollit të Bashkëpunimit me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Malit të Zi;
- Takim për përgatitjen e Protokollit të Bashkëpunimit me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës;
- Takim mbi zyrtarizimin e bashkëpunimit me Universitetin Ndërkombëtar të Strugës, Strugë FYROM: 7 korrik 2009, 4-5 nëntor 2009;
- Takim mbi zyrtarizimin e bashkëpunimit me Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë FYROM, 12-13 prill 2009;
- Takim protokollar i Kryetarit të ASH në kuadër të vizitës zyrtare të Presidentit të Republikës së Shqipërisë në Slloveni;

Vizita të ndërsjella:

- Vizitë në Fakultetin e Shkencave dhe atë Juridik në Universitetin e Barit, 15-16 tetor 2009 dhe 6-7 nëntor 2009;
 - Udhëtim studimor në Poloni, 16 - 22 nëntor 2009.
- Vizita në Akademi të:
- Atasheut kulturor i Ambasadës Ruse në Tiranë, Ania Rikova, 24 mars 2009;
 - Përfaqësuesit të Universitetit Ndërkombëtar të Strugës, 18 prill 2009;
 - Delegacionit nga Kryesia e Akademisë së Kosovës, i përbërë nga Akademik Besim Bokshi, Akademik Engjëll Berisha, Z. Zija Bylykbashi në kuadrin e nënshkrimit të Protokollit të Bashkëpunimit midis dy akademive, 4 maj 2009;
 - Presidentit të kompanisë italiane "Pedrallos", 23 maj 2009;

- Prof. Gerard T’Hooft, i nderuar me çmimin Nobel në fizikë, 18 qershor 2009;
- Atasheut Kulturor i Ambasadës Ruse, Znj. Ania Rikova dhe Prof. Aleksander Rusakov, Shef i Degës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin e Shën Petërburgut në Rusi, 14 Korrik 2009;
- Prof. Dr. Muhamed Mufaku al Arnaud, Drejtor i Qendrës për Studimin e Botës Islame në Universitetin Al-Bayt në Jordani, 7 gusht 2009;
- Delegacionit japonez nga Instituti i Teknologjisë Fukuoka, Departamenti i Elektronikës dhe Inxhinierisë Mekanike, 18 shtator 2009;
- Ambasadorit i Bullgarisë, 25 shtator 2009;
- Albanologut kroat, Alexander Stipčević, shtator 2009;
- Delegacionit nga shteti i Katarit, 6 tetor 2009;
- Presidentit dhe zëvendës-presidenti i kompanisë informatike EED me qendër në Romë të Italisë, tetor 2009;
- Prof. Ettore Curi, Sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Veronës (Itali), 22 Tetor 2009;
- Profesorëve nga një universitet jo-publik i Iranit, të shoqëruar nga Ambasadori i Republikës Iraniane në Tiranë, 29 tetor 2009;
- Kryetarit të Bashkisë së Kozencës, i shoqëruar nga Prof. Francesco Altimari (Anëtar i Jashtëm i Akademisë së Shqipërisë) dhe personalitete të tjera shkencore, 3 nëntor 2009;
- Ambasadorit i Mbretërisë së Spanjës në Tiranë, SH.T. Manuel Montobbio, më 17 nëntor 2009;
- Zëvendës-kryetarit të Akademisë së Shkencave të Rumanisë, Prof. Dan Berindei dhe Drejtori i Institutit të Studimeve për Europën Juglindore pranë kësaj Akademie, Prof. Nicolae Serban Tanasoca, 18 nëntor 2009;
- Shkrimtarit dhe Akademik Ismail Kadare (me rastin e dhënies së çmimit “Princi i Asturias”), Kryeministri Sali Berisha, ambasadori spanjoll dhe ambasadorja franceze në Tiranë, 24 nëntor 2009;
- Konsullit shqiptar në Itali, 24 dhjetor 2009.

Marrëdhëniet me mediat për veprimtari të ndryshme si:

- Seminari “FP7 dhe Vendet e Ballkanit Perëndimor” në kuadër të Projektit TRAINASA, 27 prill 2009;
- Konferenca shkencore “Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe: probleme dhe detyra”, 19 qershor 2009;
- Promovimi i veprës “Fjalori Enciklopedik Shqiptar” , Vëllimi I dhe II, 26 qershor 2009;
- Homazhe për Akademikun Petraq Pilika, 7 prill 2009;
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Universitetit të Tiranës dhe Universitetit Politeknik, 4 shtator 2009;
- Promovimi i librit “Rexhep Ramaj-modeli i intelektualit të përsosur”, me autorë Prof. Dr. Qemal Shalësi dhe Prof. Dr. Gudar Beqiraj, 5 shtator 2009;
- Procedura për pranimet në 4 vende të reja për titullin “Akademik i Asociuar” dhe për plotësimin e një vendi të lirë për titullin “Akademik i Përhershëm”, 5 tetor 2009;
- Tubimi shkencor “Prof. Dr. Andrea Shundi në 75-vjetorin e lindjes”, 23 tetor 2009;
- Seminari shkencor “Nano-teknologjia, nano-materialet dhe bio-sensorët” dhe paraqitja e librit “Biosensing using Nanomaterials”, editor Wiley-2009, me autor Akademik Arben Merkoçi, 30 tetor 2009;
- Ceremonia e dhënies së Medaljes “Nderi i Akademisë”, Profesor Aleko Mingës, 14 nëntor 2009;
- Homazhe për vdekjen e anëtarit të Akademisë, Prof. Teki Biçokut, 21 nëntor 2009 (është realizuar nga sekretaria e Kryesisë);

- Homazhe pranë arkivolit të eshtrave të Prof. Selman Rizës në përkujtim të 100-vjetorit të lindjes, 22 nëntor 2009;

- Pranimi i Prof. Salvator Bushatit si anëtar i Akademisë Europiane të Shkencave dhe Arteve, 4 dhjetor 2009;

Konferenca “Selman Riza, Gjuhëtar dhe Atdhetar i Shquar”, 14 dhjetor 2009.